



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Governme

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

Raport

**I MONITORIMIT TË KOMUNAVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

2011

Përmbajtja:

Hyrje
 Qëllimi
 Përmbledhje ekzekutive
 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës
 Transparenca
 Aktet e miratuara
 Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendeve
 Azhuriteti dhe efikasiteti i organeve të administratës
 Shkeljet ligjore
 Konkluzione
 Rekomandime

Hyrje

Në përputhje me detyrimet ligjore dhe misionin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale përmes Divizionit të Monitorimit, gjatë vitit 2011 ka vazhduar punën në drejtim të mbikëqyrjes së funksionimit të Kuvendeve të Komunave.

Ky raport vjen si rezultat i detyrimit ligjor që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me Komunat, por edhe si një mjet tjetër për të shtuar transparencën në lidhje me aktivitetet e pushtetit lokal. Lidhur me këtë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në baza periodike përgatitë raporte mbi punën e Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe organeve të administratës.

Raporti të cilin po e paraqesim, është raport përmbledhës i disa aspekteve të monitorimit të punës së organeve të Komunave, që përcaktojnë mënyrën e funksionimit të Kuvendeve të Komunave dhe efikasitetin e organeve të administratës komunale. Së këndejmi, raporti përfshinë të dhëna mbi aktivitetet e Kuvendeve të Komunave, trupave të tij, transparencën, pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, si dhe punën e organeve të administratës së komunave në kuadër të përgjegjësive në trajtimin e kërkesave të qytetarëve.

Raporti vjetor i monitorimit të komunave, duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit, ka për qëllim: pasqyrimin e gjendjes reale në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e

komunave, respektimin e legjisllacionit nga komunat, si dhe të arriturat e komunave në përgjithësi.

Në këtë raport është paraqitur progresi i punës së Kuvendeve të Komunave, përmbushja e obligimeve ligjore, duke filluar nga norma e mbledhjeve të mbajtura për këtë periudhë, aktet e miratuara në kuvend, transparencën, përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje si dhe çështje të tjera që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligje të tjera sektoriale.

Në kuadër të raportit përfshihen aktivitetet e komunave për periudhën raportuese për 34 Komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që për Komunën e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Edhe gjatë vitit 2011, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vazhdimësi ka përcjellë funksionimin dhe punën e Komunave të Republikës së Kosovës. Kjo është vazhdimësi e përpjekjeve të Divizionit të Monitorimit me qëllim të ofrimit të informatave dhe saktësisë së tyre mbi nivelin e funksionimit të organeve Komunale.

Raporti në vijim nënvizon se Komunitat qendrojnë relativisht mirë në kuptimin e përputhshmërisë së veprimeve me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, nuk duhet anashkaluar edhe konstatimin se disa aspekte mbeten për tu përmirësuar nga Komunitat, e sidomos transparenca si element i domosdoshëm për një qeverisje më të mirë lokale, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e ueb faqeve të komunave, konsultimi paraprak me organin mbikëqyrës dhe respektimi i procedurave paraprake që kërkohen para marrjes së vendimeve. Krahas kësaj, ende nuk është krijuar një sistem unik i publikimit të akteve në ueb faqet zyrtare, madje disa nuk e praktikojnë fare këtë mundësi. Kjo krijon vështirësi në informim dhe vë në pikëpyetje transparençën në këtë pikë. Sfidë për komunitat mbetet publikimi i akteve të kuvendeve në ueb faqe.

Raporti evidenton çështjet në lidhje me afatet dhe njoftimet për mbledhje të kuvendeve, numrin e mbledhjeve të Kuvendeve, transparençën e

komunave, numrin dhe përputhshmërinë e akteve komunale me legjislacionin në fuqi, përmbledhje nga mbledhjet e mbajtura, konfliktet e interesit, të gjeturat më të rëndësishme, evidencën e shkeljeve ligjore, e të tjera.

Të gjitha mbledhjet e Kuvendeve të Komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve, nga televizionet lokale. Organizimi i tubimeve publike me qytetarë kryesisht ka qenë i kënaqshëm.

Përkundër faktit që janë miratuar shumë rregullore komunale ato nuk janë sjellë tek organet mbikëqyrëse administrative për të konstatuar pajtimin ligjor siç kërkohet me provizionet ligjore. Akoma mbetet për tu dëshiruar në krijimin e një praktike më të mirë nga ana e komunave në mënyrë që t'i mundësohet organit mbikëqyrës rishikimi administrativ, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Pjesa e dytë e këtij raporti paraqet analizën në lidhje me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve komunale në procedurë administrative. Qëllimi kryesor i vlerësimit të efikasitetit dhe azhuritetit është njohja me gjendjen reale të organeve të administratës komunale në shqyrtimin e lëndëve në procedurë

administrative.

Raporti në vijim, do prezantojë të dhënat të cilat qytetarët u janë drejtuar komunave në realizimin e kërkesave në procedurë administrative. Vlen të theksohet se këtë vit për herë të parë, të dhënat janë marrë nga softueri elektronik i komunave. Ky softuer është instaluar nga MAPL-ja në të gjitha qendrat për shërbim të qytetarëve në të gjitha komunitat dhe tani e tutje këto të dhëna, rregullisht do të merren në mënyrë elektronike, krahasuar me vitet e mëparshme kur këto të dhëna janë dërguar në mënyrë fizike.

Gjithashtu, në raport do të bëhet edhe krahasimi i gjendjes së të dhënave për dy periudhat paraprake (atë të vitit 2010 dhe 2011).

Konkretisht, gjatë kësaj periudhës janar-dhjetor 2011 janë mbajtur gjithsej 369 mbledhje të rregullta dhe 28 të jashtëzakonshme. Komunitat kanë përmirësuar sistemin në drejtim të dërgimit të ftesës dhe materialeve për mbledhjeve kuvendeve. Pasqyra e të dhënave tregon se gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar edhe Komitetet e Obligueshme. Kësisoj, gjithsej janë mbajtur 369 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 238 të Komitetit për Komunitete. Sa i përket miratimit të akteve komunale, komunitat janë treguar aktive në këtë drejtim, e sidomos në nxjerrjen e

4

vendimeve nga Kuvendi. Sipas të dhënave, në Kuvendet e Komunave janë miratuar gjithsej 1308 vendime dhe 126 rregullore. Shikuar nga numri i akteve të nxjerra në kuvend, norma e shkeljeve ligjore nuk vlerësohet të jetë e madhe. Mirëpo, një numër i shkeljeve ligjore janë trashëguar nga vitet e kaluara, për shkak se komunat nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për evitimin e tyre, përkundër kërkesës së Ministrisë. Vështirësi tjetër është gjithashtu problemi se, një pjesë e konsiderueshme e komunave nuk kanë sjellë me rregull aktet e miratuara për vlerësim të rregullt të ligjshmërisë. Madje, komunat pothuajse fare nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë e konsultimit paraprak me organin mbikqëqyrës para miratimit të ndonjë akti në kuvend. Një mundësi e tillë do të ulëte edhe më tutje mundësinë e nxjerrjes së akteve të kundërligjshme.

Për dallim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, të dhënat tregojnë se në vitin 2011 ka pasur rënie të shkeljeve me rastin e nxjerrjes së vendimeve në kuvend. Ajo që vlenë të theksohet është se ende komunat hezitojnë të marrin parasysh kërkesat e MAPL-së për rishqyrtimin e vendimeve të kundërligjshme.

Përkundër disa problemeve të shfaqura, duhet nënvizuar edhe progresin e arritur për periudhën janar-dhjetor 2011. Në këtë kontekst, të gjitha komunat kanë miratuar propozim-buxhetin për vitin 2012 dhe planifikimeve strategjike të buxhetit për vitet

2012-2014. Në procesin para miratimit të buxhetit, komunat janë kujdesur të marrin edhe propozimet e qytetarëve. Kjo fazë lidhet direkt me degjimet publike, ku kanë pasur mundësinë të paraqesin propozime konkrete për projekt-buxhetin. Mirëpo, ajo që është vërejtur gjatë procesit të monitorimit, është çështja e barjtes së mjeteve financiare nga një kategori në jetrën. Kryesisht është vërejtur bartja e mjeteve nga kategoria e investimeve, apo mallërave dhe shërbimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në mungesë të mjeteve për pagesën e pagave të shërbjesve civil. Një gjë e tillë ka sjellur mundësinë e nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme me rastin e bartjes së mjeteve nga një kod buxhetor në tjetrin.

Krahas kësaj, organizimi i takimeve publike me qytetarë kryesisht ka qenë i kënaqshëm. Në këtë drejtim, janë mbajtur gjithsej 94 takime publike me qytetarë. Edhe gjatë vitit 2011 komunat kanë mbajtur takime me qytetarë në lokacione të ndryshme, si në fshatra, lagje apo vendbanime të tjera.

Trupa me rëndësi, sidomos për sigurinë publike të qytarëve në nivel komunal, por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB). Themelimi i KKSBB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet janë përcaktuar me U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL. Sipas këtij udhëzimi, kryetarët e komunave janë përgjegjës për thirrjen e

takimeve të KKSBB. Mirëpo, sipas të dhënave të paraqitura në raport, do të shohim se këto trupa nuk kanë qenë funksionale. Gjithsej janë thirrur 206 mbledhje, që shikuar në tërësi, rrjedh të jetë një mesatare prej 6 takimeve në një komunë. Kjo tregon se kryetarët e komunave nuk u kanë kushtuar rëndësi thirrjes së takimeve dhe funksionalizimit të KKSBB-ve.

Pikë tjetër specifike është mirëmbajtja e ueb-faqeve komunale me të dhëna dhe informata. Një pjesë e madhe e ueb faqeve komunale nuk azhurnohen rregullisht me të dhëna. Kryesisht, ueb faqet komunale shfrytëzohen për promovimin e aktiviteteve të kryetarëve të komunave, kurse në thelb të dhënat për aktet të cilat miratohen në kuvend mungojnë. Ky fakt krijon vështirësi për informim të drejtë të qytetarëve.

Me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë për punën e administratës së komunave, MAPL ka financuar projektin për instalimin e softuerit në komuna. Përmes këtij programi komunat kanë mundësinë e regjistrimit të të dhënave për të gjitha kërkesat e drejtuara nga qytetarët, duke filluar që nga momenti i pranimit të tyre deri në fazën përfundimtare, të shqyrtimit të kërkesave. Andaj, falë bashkëpunimit me zyrtarët komunal, tanimë është krijuar një mundësi e re për të parë të dhënat lidhur me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve të administratës së komunave.

KOMUNA E GJILANIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Gjilanit ka një sipërfaqe prej 392 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet mbi 100.000 banorë. Kuvendi i Komunës së Gjilanit numëron 41 anëtarë të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 12, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 349.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 17 mbledhje, prej tyre 14 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme.

Ecuria e tyre përgjithësisht ka shkuar mirë dhe me një dinamikë të shtuar të punës. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve, si dhe me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Aktet të cilat miratohen në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Duhet theksuar se bashkëpunimi në mes të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe MAPL-së është i kënaqshëm dhe reciprok.

Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 17 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Gjatë mbajtjes së mbledhjeve nuk ka munguar liria e shprehjes, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Pothuajse në shumicën e rasteve mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Opozita është treguar aktive dhe kritike në shumë çështje që janë diskutuar në kuvend. Roli i tyre ka qenë konstruktiv, i dobishëm dhe pozitiv gjatë këtyre proceseve. Po ashtu, vlen të përmendet se Kuvendi i Komunës ka respektuar Rregulloren e Punës.

Periudha janar – dhjetor 2011 ka rezultuar me miratimin e akteve të ndryshme, qoftë për nga prioritetet po ashtu edhe për nga rëndësia e tyre. Gjatë kësaj periudhe,

6

Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 82 vendime dhe 4 rregullore.

Në Komunën e Gjilanit, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 ka intensifikuar përpjekjet dhe ka rritur volumin e punës duke shtuar numrin e mbajtjes së mbledhjeve në 7, krahasuar me vitin 2010 ku KKSBB ka mbajtur vetëm 3 mbledhje. Përkundër ngritjes pozitive të numrit të mbledhjeve, ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSBB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Duhet përmendur se Komuna e Gjilanit ka miratuar Planin e Veprimit për vitin 2011-2013 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përmes këtij plani, komuna parasheh të zgjidh dhe të rregulloj çështjet si: infrastruktura, ambienti, përdorimi i narkotikëve dhe shpërndarja e tyre, delikuenca, riatdhesimi etj.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka përmbushur numrin e mbajtjes së mbledhjeve duke respektuar LVL-në.

Për dallim nga periudha janar – dhjetor e vitit 2010, ku Kuvendi i Komunës së Gjilanit kishte mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, për periudhën e njëjtë të vitit 2011 ka shënuar ngritje për 4 mbledhje më shumë.

Komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 17 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje. Në vitin 2011, ky Kuvend ka shtuar aktivitetin sa i përket numrit të mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së, ku krahasuar me vitin 2010, KPF kishte

mbajtur 11 mbledhje ndërsa KK 7 mbledhje.

Periudha janar – dhjetor 2011 ka rezultuar me miratimin e akteve të ndryshme, qoftë për nga prioritetet po ashtu edhe për nga rëndësia e tyre. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 82 vendime dhe 4 rregullore, derisa në periudhën e njëjtë të vitit 2010, ky Kuvend kishte miratuar 41 vendime dhe 6 rregullore.

Sa i përket transparencës së veprimtarisë së Kuvendit të Komunës së Gjilanit, ky Kuvend me rregull e bënë informimin e qytetarëve për aktivitetet e mbajtura, qoftë përmes ueb-faqes zyrtare po ashtu edhe përmes buletinit, nxjerrjes së përmbledhjeve të akteve komunale.

1.1

EVIDENTIMI I SHKELJEVE LIGJORE

Kuvendi i Komunës së Gjilanit nuk ka respektuar përbërjen gjinore me rastin e caktimit të përbërjes së Komisionit për ndryshimin e Statutit të Komunës.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Gjilanit

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Gjilanit për vitin 2011 është 64120 kërkesa, të shqyrtuara janë 56750 kërkesa ose 88.50 %. Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 49435, në vitin 2011 numri i kërkesave është rritur për 14685 kërkesa më shumë. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010, janë shqyrtuar 48473 ose 98 %. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 98% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 88.50%.

Komuna e Gjilanit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme - ka pasur gjithsej 54246 kërkesa, të shqyrtuara janë 48248 kërkesa.

2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale - ka pasur gjithsej 818 kërkesa, të shqyrtuara janë 668 kërkesa.

3 Drejtoria për Arsim - ka pasur gjithsej 186 kërkesa, të shqyrtuara janë 3 kërkesa.

4 Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - ka pasur gjithsej 783 kërkesa, të shqyrtuara janë 672 kërkesa.

5 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka pasur gjithsej 602 kërkesa, të shqyrtuara janë 404 kërkesa.

6 Drejtoria për Inspektion - ka pasur gjithsej 615 kërkesa, të shqyrtuara janë

469 kërkesa.

7 Drejtoria për Shërbime Publike - ka pasur gjithsej 786 kërkesa, të shqyrtuara janë 783 kërkesa.

8 Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari - ka pasur gjithsej 1364 kërkesa, të shqyrtuara janë 1203 kërkesa.

9 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 247 kërkesa, të shqyrtuara 197 kërkesa.

10 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim - ka pasur gjithsej 4417 kërkesa, të shqyrtuara janë 4069 kërkesa.

12 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - ka pasur gjithsej 56 kërkesa, të shqyrtuara janë 34 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka performuar kënaqshëm dhe karakterizohet me aktivitete të shumta, shtim të volumit të punës dhe avancim të përgjithshëm të shërbimeve komunale.

Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2011 ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës duke shtuar numrin e drejtorive në 12 nga 11 sa kishte, ku me këtë rast është formuar drejtoria e zhvillimit ekonomik.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Gjilanit ka raportuar para Kuvendit vetëm 1 herë gjatë vitit 2011.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Gjilanit ka mbajtur 2 takime publike me qytetarë. Më këto takime qytetarët kanë

shprehur interesim të marrin pjesë, si dhe të japin propozimet e tyre në shumë çështje të shtruar si: punësimi, infrastruktura, buxheti, kultura, shërbimet publike, regjistrimi i popullsisë, riatdhesimi etj.

Lidhur me efikasitetin e organeve të administratës së komunës, Komuna e Gjilanit ka ofruar të dhënat përmes softuerit elektronik.

1.2

REKOMANDIMET

- Në Komunën e Gjilanit, KKSB-të të jenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.
- Në Komunën e Gjilanit të përmbushet kriteri ligjor i paraparë në lidhje me raportimin e Kryetarit të Komunës para Kuvendit.

KOMUNA E KAMENICËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së mbledhjeve dhe se me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Aktet të cilat janë miratuar në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së.

Në Kuvendin e Komunës së Kamenicës, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 mbledhje

Mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Kuvendi i Komunës së Kamenicës, përgjithësisht ka funksionuar mirë e sidomos në 6 mujorin e dytë të vitit 2011, ku dukshëm vërehen përmirësimet në respektimin e lirisë së fjalës dhe kohëzgjatjes së tyre, racionalizimin e kohës së mbajtjes së mbledhjes dhe çështjeve të tjera të diskutuara në Kuvend. Roli i opozitës në zhvillimin dhe funksionimin e Kuvendit është mjaft domethënës, dhe se në rastin konkret opozita e Kuvendit të Komunës së Kamenicës është treguar aktive dhe shumë e hapur në punimet e Kuvendit. Kuvendi i Komunës ka respektuar Rregulloren e Punës.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar akte të ndryshme, të parapara dhe të ndara sipas prioritetit.

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 523 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 63.000 banorë. Kuvendi i Komunës së Kamenicës numëron 27 anëtarë të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 11, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 209.

eteve dhe objektivave. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar 48 vendime dhe 2 rregullore.

Në Komunën e Kamenicës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 ka mbajtur 3 mbledhje, krahasuar me vitin 2010, ku KKSB kishte mbajtur vetëm 1 mbledhje. Përkundër ngritjes pozitive të numrit të mbledhjeve, ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Kuvendi i Komunës së Kamenicës e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Krahasimi me vitin paraprak

Sa i përket numrit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka përmbushur numrin e tyre duke respektuar LVL-në.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2010, Kuvendi i Komunës së Kamenicës kishte mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, ndërsa për të njëjtën periudhë, atë të vitit 2011, ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Në Kuvendin e Komunës së Kamenicës, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje. Në vitin 2011, ky Kuvend është treguar më aktiv sa i përket numrit të mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së, ku krahasuar me vitin 2010, KPF kishte mbajtur 8 mbledhje, ndërsa KK 5 mbledhje.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar akte të ndryshme, të parapara dhe të ndara sipas prioriteteve dhe objektivave.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar 48 vendime dhe 2 rregullore, derisa në periudhën e njëjtë të vitit 2010, ky Kuvend kishte miratuar 49 vendime dhe asnjë rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Kamenicës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Kamenicës për vitin 2011 është 4286 kërkesa, të shqyrtuara janë 3670 kërkesa ose 85.62%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 17022, në vitin 2011 numri i kërkesave është zvogëluar për 12736 kërkesa më pak. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010, janë shqyrtuar 16912 ose 99.35%. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 99.35% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 85.62%.

Komuna e Kamenicës ka ofruar të dhëna për këto drejtori :

1 Drejtorja e Administratës dhe Personelit - ka pasur gjithsej 3744 kërkesa, të shqyrtuara janë 3649 kërkesa.

2 Drejtorja e Arsimit - ka pasur gjithsej 53 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

3 Drejtorja për Ekonomi, Buxhet dhe Financa - ka pasur gjithsej 143 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

4 Drejtorja e Inspektoriatit - ka pasur gjithsej 35 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

5 Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor - ka pasur gjithsej 49 kërkesa, të shqyrtuara janë 21 kërkesa.

10

6 Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi - ka pasur gjithsej 31 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

7 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – ka pasur gjithsej 16 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

8 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Ambient - ka pasur gjithsej 77 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

9 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 29 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

10 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - ka pasur gjithsej 61 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

11 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - ka pasur gjithsej 48 kërkesa, të shqyrtuara asnjë kërkesë.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Kamenicës

Komuna e Kamenicës gjatë vitit 2011 është treguar e vëmendshme në përmbushjen e obligimeve që ka në raport me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe ligjet tjera që janë në fuqi në Republikën e Kosovës. Përgjithësisht, Komuna e Kamenicës ka funksionuar mirë. Janë bërë përpjekje që të avancohen dhe të lehtësohen procedurat e shërbimeve komunale dhe shërbimeve të tjera.

LVL-ja (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Kamenicës i është përmbajtur obligimit ligjor duke raportuar 2 herë.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Kamenicës ka mbajtur 4 takime publike. Qytetarët kanë shprehur interesim të

marrin pjesë në këto takime dhe të shprehin mendimet e tyre në çështjet si: bujqësia, buxheti, punësimi, investimet kapitale, infrastruktura, kultura, sporti, shërbimet publike, regjistrimi i popullsisë etj.

Lidhur me efikasitetin e organeve të administratës së komunës, Komuna e Kamenicës ka ofruar të dhënat përmes softuerit elektronik.

2.1

REKOMANDIMET

- Në Komunën e Kamenicës, KKSBB-të të jenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.

KOMUNA E NOVOBËRDËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Novobërdës ka një sipërfaqe prej 91.6 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 9.670 banorë. Kuvendi i Komunës së Novobërdës numëron 15 anëtarë të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 9, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 70.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta. Edhe në Kuvendin e Komunës së Novobërdës sikurse në kuvendet paraprake, afatet ligjore të përcaktuara nga LVL për mbajtjen e mbledhjeve janë respektuar dhe me kohë kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre. Aktet e miratuara në Kuvend janë dërguar me kohë në adresë të MAPL-së të përkthyer edhe në gjuhën serbe. Po ashtu, mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Janë shënuar përmirësime në punimet e Kuvendit të Komunës sa i përket çështjeve procedurale, respektimit të fjalës, mirëpo ende mbetet për tu dëshiruar. Opozita është aktive në mbledhjet e Kuvendit, përveç komunitetit serb që pak shpreh interesimin për të marrë fjalën. Në masë të madhe është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit.

Në Kuvendin e Komunës së Novobërdës, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 mbledhje.

Akte të ndryshme janë miratuar gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Në këtë drejtim, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar 50 vendime dhe 4 rregullore.

Në Komunën e Novobërdës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 ka mbajtur 3 mbledhje, krahasuar me vitin 2010, ku KKSB nuk kishte mbajtur asnjë mbledhje. Edhe pse janë bërë përpjekje që KKSB të funksionalizohet, ky Këshill nuk

i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Kuvendi i Komunës së Novobërdës e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së

Krahasimi me vitin paraprak

Lidhur me numrin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka përmbushur numrin e tyre duke respektuar LVL-në.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2010, Kuvendi i Komunës së Novobërdës kishte mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta.

Në Kuvendin e Komunës së Novobërdës, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale për periudhën janar – dhjetor 2011. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 mbledhje. Në vitin 2011, ky Kuvend ka ngritur numrin e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së, ku krahasuar me vitin 2010, KPF kishte mbajtur 9 mbledhje, ndërsa KK 5 mbledhje.

Akte të ndryshme janë miratuar gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Në këtë drejtim, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar 50 vendime dhe 4 rregullore, derisa në periudhën e njëjtë të vitit 2010, ky Kuvend kishte miratuar 15 vendime dhe asnjë rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Novobërdës

Komuna e Novobërdës ka ofruar të dhëna për 7 drejtori komunale nga 9 sa ka gjithsej. Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të

administratës së Komunës së Novobërdës për vitin 2011 është 1095 kërkesa, të shqyrtuara janë 1077 kërkesa ose 98.35%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 355, në vitin 2011 numri i kërkesave është rritur për 740 kërkesa më shumë. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010, janë shqyrtuar 355 ose 100 %. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 100 % të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 98.35%.

Komuna e Novobërdës ka ofruar të dhëna për këto drejtori :

1 Drejtorja e Administratës dhe Personelit - ka pasur gjithsej 105 kërkesa, të shqyrtuara janë 105 kërkesa.

2 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale – ka pasur gjithsej 75 kërkesa, të shqyrtuara janë 75 kërkesa.

3 Drejtorja për Arsim, Kulturë dhe Sport – nuk ka ofruar të dhëna.

4 Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - ka pasur gjithsej 35 kërkesa, të shqyrtuara janë 35 kërkesa.

5 Drejtorja për Urbanizëm dhe Kadastër - ka pasur gjithsej 735 kërkesa, të shqyrtuara janë 719 kërkesa.

6 Drejtorja për Inspektion - ka pasur gjithsej 28 kërkesa, të shqyrtuara janë 28 kërkesa.

7 Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë Civile - ka pasur gjithsej 10 kërkesa, të shqyrtuara janë 8 kërkesa.

8 Drejtorja për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural - nuk ka ofruar të dhëna.

9 Drejtorja për Gjeodezi dhe Pronë – ka pasur gjithsej 107 kërkesa, të shqyrtuara janë 107 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Novobërdës

Komuna e Novobërdës gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht dhe sipas dinamikës së paraparë. Në këtë drejtim, Komuna e Novobërdës ka vepruar në bazë të planifikimeve të cilat kanë ndikuar drejtë për së drejti në ngritjen dhe avancimin e përgjithshëm të Komunës. Vlen të përmendet se Komuna e Novobërdës ka përfituar donacione të jashtme, ndër to mund të përmendim fushën e infrastrukturës ku Komisioni Evropian ka ndarë mjete për ndërtimin e qendrës për kulturë dhe sport.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Novobërdës nuk ka raportuar para Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2011.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Novobërdës ka mbajtur 4 takime publike. Qytetarët relativisht kanë shprehur interesim të marrin pjesë në këto takime publike. Temat të cilat janë diskutuar kanë

3.1

REKOMANDIMET

- Në Komunën e Novobërdës, KKSBB-të të jenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.
- Në Komunën e Novobërdës të përmushet kriteri ligjor i paraparë në lidhje me raportimin e Kryetarit të Komunës para Kuvendit.
- Komuna e Novobërdës të funksionalizojë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;

qenë kryesisht të fokusuara në çështjet si: punësimi, investimet kapitale, infrastruktura, bujqësia, buxheti, kultura, sporti, shërbimet publike, ambienti, regjistrimi i popullsisë, riatdhesimi etj.

Lidhur me efikasitetin e organeve të administratës së komunë, Komuna e Novobërdës ka ofruar të dhëna për 7 drejtori nga 9 sa ka gjithsej përmes mënyrës fizike të plotësimi

KOMUNA E RANILLUGUT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Ranillugut ka një sipërfaqe prej 77.62 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 6000 banorë. Kuvendi i Komunës së Ranillugut numëron 15 anëtarë të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 6, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 50.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Ranillugut gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Sa i përket njoftimit dhe mbajtjes së mbledhjeve, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve, si dhe me kohë ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Rendi i ditës dërgohet përmes emailit zyrtar dhe është i përkthyer në gjuhën shqipe, mirëpo materialet e kuvendit shpesh ndodh të mos përkthehen në gjuhën shqipe për shkak se në tërë Komunën vepron vetëm një (1) përkthyes. Gjatë monitorimit të mbledhjeve të kuvendit, përkthyesi është prezent dhe bënë përkthimin e mbledhjeve nga gjuha serbe në atë shqipe. Aktet të cilat miratohen në kuvend, përkthehen në gjuhën shqipe dhe dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Kuvendi i Komunës së Ranillugut karakterizohet për efikasitet dhe efektivitet të punës. Opozita është pak aktive, mirëpo e hapur dhe në mbrojtje të qëndrimeve të tyre. Rregullorja e Punës së Kuvendit është respektuar.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale në Kuvendin e Komunës së Ranillugut,. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 mbledhje

Akte të ndryshme janë miratuar gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Lidhur me këtë çështje, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar 45 vendime dhe 9 rregullore,

Në Komunën e Ranillugut, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 nuk ka mbajtur

asnjë mbledhje, ndërsa në vitin 2010 KKSBB ende nuk ishte e themeluar. Ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSBB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Kuvendi i Komunës së Ranillugut e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka përm-bushur numrin e mbajtjes së mbledhjeve duke respektuar LVL-në.

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2010, Kuvendi i Komunës së Ranillugut kishte mbajtur 7 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, komitetet obligative dhe komitetet e tjera kanë qenë funksionale në Kuvendin e Komunës së Ranillugut. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 3 mbledhje. Në vitin 2010, KPF kishte mbajtur 7 mbledhje, ndërsa KK 5 mbledhje.

Akte të ndryshme janë miratuar gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Lidhur me këtë çështje, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar 45 vendime dhe 9 rregullore, derisa në periudhën e njëjtë të vitit 2010, ky Kuvend kishte miratuar 57 vendime dhe 8 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Ranillugut

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Ranillugut për periudhën janar-dhjetor të vitit 2011 është

1077, të shqyrtuara janë 1055 ose marrë në përqindje është 97.95%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 58, në vitin 2011 numri i kërkesave është rritur për 1019 kërkesa më shumë. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010, janë shqyrtuar 50 ose 86.20 %. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 86.20 % të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 97.95 %.

Komuna e Ranillugut ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtorja e Administratës dhe Personelit - nuk ka pasur asnjë kërkesë.

2 Drejtorja për Buxhet dhe Financa - ka pasur gjithsej 51 kërkesa, të shqyrtuara janë 50 kërkesa.

3 Drejtorja e Arsimit, Shëndetësisë dhe Kulturës - ka pasur gjithsej 75 kërkesa, të shqyrtuara janë 64 kërkesa.

4 Drejtorja e Urbanizimit, Kadastër dhe Gjeodezi – ka pasur gjithsej 819 kërkesa, të shqyrtuara janë 809 kërkesa.

5 Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - ka pasur gjithsej 130 kërkesa, të shqyrtuara janë 130 kërkesa.

6 Drejtorja për Shërbime Publike – ka pasur gjithsej 2 kërkesa, të shqyrtuara janë 2 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Ranillugut

Komuna e Ranillugut gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011 është treguar efikase dhe efektive në punën e saj. Po ashtu, edhe Komuna e Ranillugut ka qenë përfituese e donacioneve të ndryshme duke përfshirë: infrastrukturën, shërbimet e brendshme të

16

komunës, instalimin e pajisjeve të komunikimit në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, si dhe shumë përfitime të tjera në fusha të ndryshme.

Komuna e Ranillugut ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës duke hapur mundësinë që në kuadër të saj të bëhet sistematizimi dhe organizimi i brendshëm i administratës komunale.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Ranillugut ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2011.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Ranillugut ka mbajtur 2 takime publike me qytetarë. Qytetarët kanë shprehur interesim të mirë të marrin pjesë në këto takime publike. Ndër çështjet që janë diskutuar mund të përmendim si: investimet kapitale, infrastruktura, bujqësia, buxheti etj. Lidhur me efikasitetin e organeve të admini-

4.1

REKOMANDIMET

- Në Komunën e Ranillugut, të funksionalizohet KKSBB, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.
- Komuna e Ranillugut të fuksonalizojnë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunën e Ranillugut të sigurohet edhe një përkthyes nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas për shkak të lehtësimit të dërgimit të akteve komunale, ftesës dhe materialit për mbledhje, si dhe shumë çështjeve të tjera procedurale në drejtim të organit mbikëqyrës;

stratës së komunave, Komuna e Gjilanit dhe Kamenicës kanë ofruar të dhëna përmes softuerit elektronik, Komuna e Ranillugut ka ofruar të dhënat përmes mënyrës fizike të plotësimin.

KOMUNA E DEÇANIT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Deçanit, ka një sipërfaqe prej 371 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 40.000 banorë. Kuvendi i Komunës së Deçanit numëron 27 anëtarë të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është njëmbëdhjetë (11), ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 138.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Deçanit ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Ndërsa, sa u përket Komiteteve të obligueshme, ato kanë mbajtur nga 11 mbledhje. Në këtë periudhë, Kuvendi ka miratuar gjithsej 23 vendime dhe 3 rregullore.

Të dhënat tregojnë se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Komuna ka organizuar 2 tubime publike me qytetarë. Po ashtu, nuk është shënuar ndonjë rast i paraqitjes së konfliktit të interesit, si nga ana e Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e Kryetarit. Për më tepër, gjatë monitorimit të mbledhjeve të kuvendit, nuk është raportuar ndonjë rast i konfliktit të interesit. Me rastin e votimit për ndonjë çështje në kuvend, nuk ka pasur raste kur anëtarët e kuvendit janë tërhequr nga votimi për shkak të konfliktit të interesit ose nuk kanë paraqitur ndonjë bazë dyshimi për anëtarët e tjerë të kuvendit lidhur me konfliktin e interesit.

Kuvendi i Komunës ka të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë kësaj periudhë KKSBB ka mbajtur 5 mbledhje. Të dhënat mbi numrin e takimeve të KKSBB-së tregojnë se ky këshill nuk qëndron në hap me normën e paraparë për mbledhjet e KKSBB-ve sipas nenit 7.1 të U.A. nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.

Komuna e Deçanit ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar. Ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale.

18

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, në vitin 2011 Kuvendi i Komunës së Deçanit ka mbajtur një mbledhje më pak. Numri i mbledhjeve të komiteteve të obligueshme tregon ritëm të njëjtë të aktivitetit në të dy vitet. Kurse, dinamika e miratimit të akteve në Kuvend pasqyrohet më numër më vogël të vendimeve të miratuara në vitin 2011, tregues i kësaj janë 14 vendime më pak të miratuara sesa në vitin 2010.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Deçanit

Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet administrative të Komunës së Deçanit për vitin 2011 është 5094 kërkesa, të shqyrtuara janë 3234 kërkesa ose 63.48% ndërsa, 1860 nuk janë shqyrtuar ende.

Përderisa në vitin 2010 ishin pranuar gjithsej 2974 kërkesa, në vitin 2011 komuna ka pranuar 2120 kërkesa më shumë. Norma e lëndëve të shqyrtuara në vitit 2010 ka qenë 96.6%, kurse në vitin 2011 ajo është dukshëm më e ulët me 63.48%, ngase edhe numri i lëndëve të paraqitura ishte pothuajse dyfish më i madh sesa në vitin paraprak.

Komuna e Deçanit ka ofruar informata për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës - të pranuar gjithsej 816 kërkesa, të shqyrtuar 793 dhe të pasqyrtuara 23 lëndë.

2 Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit – të pranuar 348, të shqyrtuara 303, të pasqyrtuara 45.

3 Drejtoria për Buxhet dhe Financa – të pranuar 147, të shqyrtuara 138, të pasqyrtuara 9 kërkesa.

4 Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – të pranuar 86, të shqyrtuara 44, të

5.1

EVIDENTIMI I SHKELJEVE LIGJORE

- MAPL ka dhënë përgjigje në ankesë lidhur me mosrespektimin e procedurave të shpronësimit e pronës private nga Komuna e Deçanit, me rastin e zbatimit të projektit të zgjerimit të rrugës “Emin Duraku” në Deçan, projekt i cili është paraparë të financohet nga MAPL. Pas konstatimit të shkeljes, MAPL ka pezulluar financimin e këtij projekti dhe ka kërkuar nga Komuna e Deçanit të respektoj procedurat për shpronësimin e pronës private sipas Ligjit mbi Shpronësim.
- Edhe gjatë kësaj periudhe, numri i drejtorive në komunë ka qenë dhe mbetet në kundërshtim me Statutin e Komunës. Përkundër shkresës së MAPLsë, Komuna nuk ka arritur të harmonizoj Statutin me numrin e zgjeruar të drejtorive.
- Me nenin 22.7 të Statutit të Komunës së Deçanit parashihet që propozimbuxheti i komunës të aprovohet me 2/3 e votave, e që nuk përkon me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Loakle. Ky fakt ka bërë që në dy vitet e fundit, propozimbuxheti i Komunës së Deçanit të mos marrë numrin e mjaftueshëm prej 2/3 të kuvendarëve me rastin e votimit të propozimbuxhetit.

pashqyrtuara 41 kërkesa.

5 Drejtoria për Arsim – të pranuar 923, të shqyrtuara 815, të pasqyrtuara 106.

6 Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – të pranuar 300, të shqyrtuara 139 kërkesa, 161 të pasqyrtuara,

7 Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike – të pranuar 237, të shqyrtuara 219, të pashqyrtuara 18.

8 Drejtoria për Inspektion – të pranuar 151, të shqyrtuara 112, të pashqyrtuara 39.

9 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim – të pranuar 106, të shqyrtuara 101, të pashqyrtuara 5.

10 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – të pranuar 1,797, të shqyrtuara 395, të pashqyrtuara 1402

11 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – të pranuar 123, të shqyrtuara 112, të pashqyrtuara 11.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Deçanit

Përgjithësisht ecuria e mbledhjeve të kuvendit të komunës ka qenë e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Në këtë komunë nuk janë paraqitur raste të lëshimit të mbledhjes nga anëtarët e kuvendit të komunës. Në mënyrë të njëtrajtshme janë zhvilluar edhe takimet e komiteteve të obligueshme. Të gjitha takimet e kuvendeve dhe trupave kanë qenë transparente. Sa i përket obligimit të kryetarit të

5.2

REKOMANDIMET

- Të harmonizohet Statuti i Komunës me numrin e drejtorive.
- Të korrigjohet përmbajtja e Statutit të Komunjës dhe të harmonizohet me dispozitat e LVL-së.
- Vendimet e kundërligjshme të rishqyrtohen në kuvend.

komunës për të raportuar para kuvendit, ai është treguar i gatshëm në këtë drejtim.

Për dallim nga disa komuna të tjera, në Kuvendin e Komunës së Deçanit duhet vlerësuar rolin konstruktiv të opozitës. Së këndejmi, opozita në vazhdimësi ka qenë kritikuese ndaj punës së ekzekutivit. Në çdo moment, nga kryetari i komunës është kërkuar sjellja e raporteve për zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës, por edhe vendimeve të nxjerra nga kryetari. Ecuria e mbledhjeve të kuvendit ka qenë pothuajse e njëjtë me një vit më parë, ndërsa është shënuar vetëm një rast i bojkotimit të mbledhjes së kuvendit. Në komunën e Deçanit në vazhdimësi është përcjellë problemi i Statutit të Kuvendit, problemin e kalimit të projektbuxhetit në kuvend dhe drejtoritë shtesë në kundërshtim me numrin e paraparë me Statut.

KOMUNA E JUNIKUT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Junikut, ka një sipërfaqe prej 77.7 km². Popullsia, në këtë komunë është rreth 96000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është shtatë (7), ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 62 me ekzekutiv.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Ndërsa, janë realizuar 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete. Sa u përket akteve të miratuara në kuvendin e komunës, gjithsej janë miratuar 23 vendime dhe 4 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Gjithashtu, nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

Komuna e Junikut ka organizuar edhe takime publike me qytetarët. Në këtë drejtim, me qëllim të informimit dhe konsultimit me komunitetin komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë, duke përmbytur obligimin ligjor.

Sa i përket Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi gjatë vitit 2011 ka mbajtur vetëm 2 mbledhje, shifër që tregon jo funksionalitetin e këtij organi.

Komuna e Junikut, ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale.

Krahasimi me vitin paraprak

Sa i përket dinamikës së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në vitin 2011 nuk qëndron ndonjë dallim esencial me periudhën e njëjtë të vitit 2010 për nga numri i takimeve. Ndërsa shikuar nga aspekti përmbajtjesor i takimeve, në vitin 2011 kemi rënie për nga vëllimi i akteve të miratuara. Këtë e argumenton numri prej 11 akteve më pak të miratuara në vitin 2011.

Sa u përket Komiteteve të obligueshme, në vitin 2011 rezulton aktivitet dukshëm më i shtuar në krahasim me vitin 2010. Në vitin 2010 KPF kishte mbajtur 9 takime, dërsia KK 6. Shifrat tregojnë se rëndësia e këtyre trupave në Komunën e Junikut është rritur dukshëm gjatë vitit 2011.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Junikut

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat për drejtoritë e komunës.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Junikut për vitin 2011 është 6559 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë 6505 ose marrë në përqindje del të jetë 99.17%.

Përderisa në vitin 2010 ishin pranuar gjithsej 3549 kërkesa, në vitin 2011 komuna ka pranuar 3010 kërkesa më shumë, pra gjithsej 6559. Norma e lëndëve të shqyrtuara në vitin 2010 ka qenë 100%, në vitin 2011 ajo është pothuajse e njëjtë me 99.17%, pavarësisht rritjes së numrit të kërkesave për shqyrtim.

Komuna e Junikut ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës – ka pasur gjithsej 5025 kërkesa, të shqyrtuara janë 5025 kërkesa.

2 Drejtoria për Buxhet dhe Financa - ka pasur gjithsej 62 kërkesa, të shqyrtuara janë 61 kërkesa.

3 Drejtoria për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 27 kërkesa, të shqyrtuara janë 21 kërkesa.

4 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – ka pasur 19 kërkesa, të shqyrtuara janë 7 kërkesa.

4 Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis - ka pasur 928 kërkesa, të shqyrtuara janë 920 kërkesa.

5 Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim – ka pasur 115 kërkesa, janë shqyrtuar 89 kërkesa.

6 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim – ka pasur 383 kërkesa, të shqyrtuara janë 382 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Junikut

Përgjithësisht ecuria e mbledhjeve të kuvendit të komunës ka qenë e njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Në këtë komunë nuk janë paraqitur raste të lëshimit të mbledhjes nga anëtarët e kuvendit të komunës. Në mënyrë të njëtrajtshme janë zhvilluar edhe takimet e komiteteve të obligueshme. Të gjitha takimet e kuvendeve dhe trupave kanë qenë transparente. Sa i përket obligimit të kryetarit të komunës për të raportuar para kuvendit, ai është treguar i gatshëm në këtë drejtim.

KOMUNA E GJAKOVËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Gjakovës përbëhet prej 89 fshatrave me qendër në Gjakovë, me një sipërfaqe prej 586 km². Popullsia në këtë komunë sillet rreth 150.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është 12 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 313.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Po ashtu, janë mbajtur 9 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 7 të Komitetit për Komunitete. Akte të miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2011 janë gjithsej 31, përfshirë 26 vendime dhe 5 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Gjithashtu, nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës. Sa i përket raportimit të kryetarit para kuvendit të komunës, ky obligim ligjor është përmbushur. Kryetari ka raportuar 2 herë para kuvendit të komunës.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi gjatë vitit 2011 ka mbajtur 2 mbledhje.

Komuna e Gjakovës ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të paraparë, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, Kuvendi i Komunës ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve. Derisa KPF në vitin 2011 ka treguar rritje të numrit të mbledhjeve për 2 mbledhje më shumë se sa gjatë vitit 2010, poashtu edhe KK ka mbajtur 1 mbledhje më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sa u përket akteve të miratuara, të dhënat tregojnë se në vitin 2011 janë miratuar 3 rregullore më shumë, ndërsa 5 vendime më pak se në vitin 2010. Përafërsisht intensiteti në

miratimin e vendimeve dhe rregulloreve është i ngjashëm mes dy viteve.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Gjakovës

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat për drejtoritë e komunës.

Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet administrative të Komunës së Gjakovës për vitin 11 është 6926 kërkesa, të shqyrtuara janë 6308 kërkesa ose 91.07% ndërsa, 618 janë të pashqyrtuara.

Përderisa në vitin 2010 ishin pranuar gjithsej 8614 kërkesa, në vitin 2011 komuna ka pranuar 2359 kërkesa më pak. Norma e kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2010 ka qenë 92.7%, ndërsa në vitin 2011 ajo është pak më e ulët, 91.07%.

Komuna e Gjakovës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria për Administratë dhe Personel – të pranuar gjithsej 1698 kërkesa, të shqyrtuar 1650 dhe të pashqyrtuara 40 lëndë.

2 Drejtoria për Buxhet dhe Financa – të pranuar gjithsej 171 kërkesa, të shqyrtuar 140 dhe nuk janë shqyrtuar ende 31 lëndë.

3 Drejtoria për Arsim dhe Shkencë - të pranuar 1,027, kërkesa, të shqyrtuara 983, ndërsa të pashqyrtuara 44.

4 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - të pranuar 584, kërkesa, të shqyrtuara 565, ndërsa të pashqyrtuara 19

5 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – të pranuar 1176 kërkesa, të shqyrtuara 1127, te pashqyrtuara 49

6 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Rural - të pranuar 606, të

shqyrtuara 450, të pashqyrtuara 156 kërkesa.

7 Drejtoria për Agrokulturë – të pranuar 47, të shqyrtuara 21, të pashqyrtuara 26 kërkesa.

8 Drejtoria për Shërbime Publike - të pranuar 175, janë shqyrtuar 161, të pashqyrtuara 14 kërkesa.

9 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – të pranuar 95 kërkesa, të shqyrtuara 89, të pashqyrtuara 9 kërkesa.

10 Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë – të pranuar 127, të shqyrtuara 5, të pashqyrtuara 122.

11 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim - të pranuar 136 kërkesa, të shqyrtuara 130, të pashqyrtuara 6

12 Drejtoria për Punë të Inspeksionit - të pranuar 1,084 kërkesa, të shqyrtuara 982, të pashqyrtuara 102.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Gjakovës

Në përgjithësi performanca e Kuvendit të Komunës si dhe organeve të tjera vlerësohen të jenë e lartë. Komuna e Gjakovës sikurse viteve të kaluara, edhe në vitin 2011 ka treguar kulturë politike gjatë zhvillimit të punimeve në Kuvend. Janë anëtarët e kuvendit ata të cilët në çdo moment kanë treguar kujdes gjatë komunikimit zyrtar, duke respektuar rregulloren e punës së kuvendit në të gjitha pikat. Është vërejtur koordinim i mirë i punës së anëtarëve të subjekteve politike të kuvendit, gjë që ka shmangur debatet e panevojshme e të tejzgjatura, siç ka ndodhur në disa komuna të tjera. Gjithashtu, kryetari i komunës është treguar mjaft i afërt me kuvendin e komunës, ku prezenca e tij dhe e drejtorëve në mbledhje, ka qenë pothuajse çdo herë e evidente.

KOMUNA E RAHOVECIT

Informacion i përgjithshëm

Territori i komunës së Rahovecit ka një sipërfaqe prej 276 km². Komuna e Rahovecit ka mbi 78 674 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 31 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 11 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 173.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-shtator 2011, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Krahas kuvendit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar pa pengesa gjatë kësaj periudhe, me ç' rast ka mbajtur gjithsej 11 takime. Përderisa Komiteti për Komunitete pothuajse 2 vite nuk kishte funksionuar pasi që nuk kishte përbërje të plotë, në fund të vitit 2011 ky komitet ka rregulluar përbërjen, duke mbajtur kështu mbledhjen konstituive. Sa u përket akteve të miratuara, janë nxjerrë gjithsej 13 vendime dhe 3 rregullore, gjë që tregon pasivitetin e kuvendit në këtë drejtim.

Komuna e Rahovecit ka respektuar dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje lokale lidhur me njoftimin për mbajtje të mbledhjeve, gjithashtu është treguar e gatshme për shkëmbimin e të dhënave dhe informatave në raport me autoritetin mbikëqyrës.

Për këtë periudhë, Kryetari i komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna në periudhën e këtij viti raportues ka mbajtur 2 takime publike me qytetarë në sallën e kuvendit të komunës dhe 6 takime të tjera në lokalitete të tjera të komunës.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Rahovecit për periudhën një vjeçare nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe ka pranuar vetëm një kërkesë për peticion. Nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, gjithashtu edhe Kryetari nuk ka pasur rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Në komunën e Rahovecit është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Numri i takimeve të këtij këshilli gjatë kësaj periudhe është 3 herë, tregues i pasivitetit të këtij organi.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në vitin 2011 ka mbajtur një mbledhje më shumë se në vitin 2010. Megjithëse është realizuar një mbledhje më shumë, kuvendi ka treguar rënie në efektshmërinë e nxjerrjes së akteve juridike. Derisa në vitin 2010 ishin miratuar 22 akte, në vitin 2011 janë miratuar 16 të tilla. Këto shifra në të dy vitet tregojnë nivelin e ulët të efikasitetit të Kuvendit në nxjerrjen e akteve normative. Mosmarrëveshjet e paraqitura në kuvend nga subjektet përbërëse, lidhur me propozimet e akteve për shqyrtim, në disa raste kanë përfunduar me ndërprerje të mbledhjeve, shtyrjes së tyre apo mosmiratim të rendit të ditës. Një gjë e tillë është përcjellë në të dy vitet.

Krahas kuvendit, në vitin 2011 është vërejtur ngjallje të punës së komiteteve obligative. Në vitin 2010 në këtë komunë KPF kishte mbajtur vetëm 6 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur gjithsej 11. Edhe Komiteti për Komunitete ka arritur të funksionalizohet në vitin 2011, duke ditur se që nga nxjerrja e vendimit për themelimin e këtij komiteti, nuk kishte arritur të kompletoj përbërjen, për shkak të mungesës së përfaqësuesve nga komuniteti serb.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Rahovecit

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat për drejtoritë e komunës.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Rahovecit për vitin 2011 është 5552 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë 3685 kërkesa ose 66.37%, ndërsa të pashqyrtuara janë 1867 kërkesa ose 33.62%.

Numri i kërkesave të paraqitura në drejtoritë e komunës në vitin 2011 është shumë më e vogël se ato të paraqitura një vit më parë. Derisa në vitin 2010 komuna kishte pranuar 19933 kërkesa, në vitin 2011 janë pranuar

8.1

EVIDENTIMI I SHKELJEVE LIGJORE

- MAPL ka pranuar kërkesën e ICO-së lidhur me shqyrtimin e veprimeve të Komunës së Rahovecit me rastin e zgjerimit të rrugës në pronën e Manastirit të Zoqishtës. Pas vlerësimit të rastit, MAPL ka konstatuar se Komuna e Rahovecit, me rastin e zgjerimit të rrugës për në fshatin Zoqisht nuk ka respektuar procedurat që kërkohen sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të mbrojtura. Pas kërkesës së Ministrisë lidhur me rishqyrtim të këtij vendimi, Komuna ka ndërmarrë hapa në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të MAPL-së.
- Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka bërë shkelje ligjor me rastin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim pa kompensim dhe pa respektuar procedurat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme komunale. Komuna nuk ka kthyer për rishqyrtim këtë vendim edhe pas kërkesës së MAPL-së.

5552 kërkesa, apo 14381 më pak. Ndërsa po të masim përqindjen e lëndëve të shqyrtuara, pavarësisht numrit të lëndëve, në vitin 2010 janë shqyrtuar 99% të kërkesave, ndërsa në vitin 2011 përqindja e lëndëve të shqyrtuara është dukshëm më e zvogëluar, pra 66%.

Komuna e Rahovecit ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës dhe Personelit - ka pasur gjithsej 2231 kërkesa, të shqyrtuara 1792 kërkesa.

2 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka pasur gjithsej

26

kërkesa, të shqyrtuara kërkesa, ndërsa kërkesa mbeten të pashqyrtuara.

3 Drejtoria për Financa, Buxhet - ka pasur gjithsej 538 kërkesa, të shqyrtuara 476 kërkesa.

4 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 37 kërkesa, të shqyrtuara 19 kërkesa.

5 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - ka pasur gjithsej 201 kërkesa, të shqyrtuara 55 kërkesa, ndërsa 146 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende

6 Drejtoria për Punë Inspektuese - ka pasur gjithsej 1186 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 813 kërkesa.

7 Drejtoria e Arsimit - ka pasur gjithsej 29 kërkesa, të shqyrtuara 24 kërkesa.

8 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - ka pasur gjithsej 438 kërkesa, të shqyrtuara janë 428 kërkesa.

9 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim - ka pasur gjithsej 295 kërkesa, të shqyrtuara janë 58 kërkesa.

10 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - ka pasur gjithsej 10 kërkesa, të shqyrtuara 10 kërkesa.

11 Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë - ka pasur gjithsej 313 kërkesa, të shqyrtuara 2 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Rahovecit

Duke analizuar punën e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për këtë periudhë,

8.2

REKOMANDIME

- Kuvendi i Komunës së Rahovecit të jetë më aktiv në nxjerrjen e akteve komunale.
- Të respektohet plotësisht Rregullorja e Punës së Kuvendit.
- Të merren parasysht kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të kundërligjshme.

mund të themi se kuvendi nuk ka treguar performancë edhe aq të mirë. Është vënë re se gjatë mbajtjes së mbledhjeve, anëtarët e kuvendit nuk kanë respektuar plotësisht Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kjo është reflektuar në shumë drejtime, duke përfshirë: mosrespektim të rendit me rastin e marrjes së fjalës, diskutime të panumërta nga një person dhe për të njëjtën çështje, tejkallim të limitit kohor gjatë shprehjes së mendimeve, gjuhën e komunikimit etj. Ky fakt ka ndikuar që kryesuesi i kuvendit të hasë në vështirësi gjatë udhëheqjes së mbledhjeve dhe në zbatimin e Rregullores së Punës së Kuvendit. Edhe në vitin 2011, nuk kanë munguar rastet e dështimit të mbledhjeve, për shkak të mosmiratimit të rendit të ditës. Në këtë komunë janë evidentuar disa raste të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme në kuvend/ Ndërsa, si progres i arritur gjatë kësaj periudhe është funksionalizimi i Komitetit për Komunitete.

Sa i përket kryetarit të komunës, ai është shprehur i përkushtuar ndaj bashkëpunimit me Kuvendin e Komunës. Madje, në shumë pika kryetari është treguar i gatshëm në marrjen e pëlqimit të qytetarëve. Janë mbajtur shumë takime me qytetarë në lokacione të ndryshme, gjë që këtë komunë e bëjnë më të përkushtuar ndaj sjelljes së qytetarit më afër vendimarrjes. Në përgjithësi komuna është treguar bashkëpunuese me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokale.

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Fushë Kosovës përbëhet prej 17 fshatrave me qendër në Fushë-Kosovë, me një sipërfaqe prej 100 km². Popullsia prej rreth 50.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 27 anëtarë. Numri i drejtorive është 11, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 142.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente për publikun. Në këto mbledhje është vërejtur prezenca e medieve, organizatave joqeveritare si dhe ekzekutivit të komunës ku ç`do herë kanë qenë të gatshëm të përgjigjen në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Vendimet merren me shumicë të votave, pasi në këtë komunë ekziston konsensusi politik ndërmjet grupeve parlamentare.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhjetë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës ka qenë mjaft efikas në miratimin e akteve komunale, ku gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 44 vendime dhe 3 rregullore.

Duhet theksuar se në këtë vit kjo komunë ka miratuar Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal për periudhën 2011-2014.

Po ashtu, ka arritur marrëveshje për binjakëzim me Komunën e Silifikës në Turqi.

Është miratuar Plani i Veprimit për integrimin të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian për periudhën 2010-2012.

KKSB, është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të gjitha bashkësive në një komunë. Në këtë Komunë deri më tani ky këshill ka mbajtur vetëm 1 mbledhje përderisa në vitin 2010 ka mbajtur vetëm 2 mbledhje.

Krahasimi me vitin paraprak

Përderisa Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës në periudhën e vitit 2011 ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe asnjë të jashtëzakonshme, në periudhën e njëjtë por atë të vitit 2010 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete, krahasuar me vitin paraprak të 2010 KPF ka mbajtur 8 mbledhje ndërsa KK 10. Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare .

Kuvendi ka qenë mjaft efikas në miratimin e akteve komunale dhe gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 44 vendime dhe 3 rregullore, ndërsa krahasuar me vitin 2010 ishin miratuar 25 vendime dhe 4 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Fushë Kosovës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të pranuar në organet e administratës së Komunës së Fushë-Kosovës është 4315, ndërsa janë shqyrtuar 3122 ose 72.35 % .

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 5331 në vitin 2011 numri i kërkesave është 4315. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 5182 ose 97,20 % . Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 97.20% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 72.35%.

Komuna e Fushë Kosovës ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit - janë pranuar gjithsej 24 kërkesa, të shqyrtuar 15 ndërsa të pashqyrtuar 9.

2 Drejtoria për Administratë dhe Shërbim të Përbashkët - janë pranuar gjithsej 12 kërkesa, të shqyrtuara 0 të pashqyrtuara 10

3 Drejtoria për Ekonomi dhe Buxhet dhe Financa - janë pranuar 1427 kërkesa, janë shqyrtuar gjithsej 1377 të, ndërsa të pashqyrtuara 50 kërkesa.

4 Drejtoria për Planifikim Urban dhe Kadastër - janë pranuar gjithsej 2305 kërkesa, të shqyrtuara 1421, ndërsa të pa shqyrtuar 884.

5 Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - janë pranuar gjithsej 101 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

6 Drejtoria për Inspektion - janë pranuar gjithsej 59 kërkesa, 44 të shqyrtuara, të pashqyrtuara 15

7 Drejtoria për Arsim dhe Shkencë - ka pasur gjithsej 56 kërkesa, të shqyrtuara 34 të pashqyrtuara 22 .

8 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka pranuar 96 kërkesa të shqyrtuara 95, ndërsa 1 të pashqyrtuar .

9 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka pranuar 240 kërkesa, të shqyrtuara 35 të pashqyrtuara 205

10 Drejtoria për Integritet Evropian - nuk ka pranuar asnjë të dhënë

11 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - ka pranuar 187 kërkesa, të shqyrtuar 0, të pashqyrtuara 187.

12 Zyra për komunitete - ka pranuar 24 kërkesa të shqyrtuara 0 të pashqyrtuara 24.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Fushë Kosovës

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës funksionon, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe kuvendi është brenda dinamikës së mbajtjes së mbledhjeve. Gjatë këtyre mbledhjeve janë miratuar një numër i konsiderueshëm të akteve komunale.

Po ashtu këto mbledhje kanë qenë transp-

arente për publikun, ftesat për mbledhje iu dërgohen me kohë anëtarëve të kuvendit dhe MAPL-së.

Edhe komitet obligative si trupa të kuvendit kanë funksionuar normalisht duke mbajtur mbledhje paralelisht me mbledhjet e kuvendit. Kryetari i Komunës ka raportuar 4 herë para anëtarëve të kuvendit, ndërsa sa i përket tubimeve publike nuk janë respektuar dispozitat ligjore, pasi ka mbajtur vetëm një tubim me publik. Sa i përket funksionimit të organeve të administratë gjatë kësaj periudhe, kjo komuna është treguar mjaft efikase sa i përket realizimit të kërkesave të qytetarëve.

9.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Fushë - Kosovës të respektoj dispozitat ligjore sa i përket takimeve publike.**

KOMUNA E LIPJANIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Gjatë kësaj periudhe 2011, mbledhjet e kuvendit kanë qenë transparente për publikun, ftesat dhe materialet dërgohen me kohë si anëtarëve të kuvendit po ashtu edhe MAPL-së.

Rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës, është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita po ashtu edhe nga pozita, për pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 9 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Lipjanit gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 26 vendime dhe 2 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare.

KKSB, si qëllim ka vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet. Në Komunën e Lipjanit ky këshill gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 6 mbledhje, dhe një tubim me qytetarë.

Krahasimi me vitin paraprak

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010 gjendja e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit është e njëjtë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 9 mbledhje të Komitetit për Komunitete, krahasuar me vitin

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Lipjanit, ka një sipërfaqe prej 422 km². Popullsia në këtë komunë sillet rreth 75.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive me Statutin e Komunës është 11, ndërsa Kryetari i Komunës ka nxjerrur një vendim ku është rritur numri i drejtorive në trembëdhjetë pa iu nënshtruar procedurave të ndryshimit të Statutit. Ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 203.

2010 ku KPF ka mbajtur 7 dhe KK 7. Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Lipjanit ka ngritur komitete konsultative. Ndërkohë, Kuvendi i Komunës ka funksionale edhe katër komitete të tjera, të konsideruara të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tij.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 janë miratuar gjithsej 26 vendime dhe 2 rregullore, krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka miratuar 28 vendime dhe 3 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Lipjanit

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitur para organeve të administratës së Komunës së Lipjanit, është 10,685 kërkesa, prej të cilave 9646 kërkesa janë shqyrtuar ose 90.27%.

Krahasuar me vitin 2010 ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 6856 në vitin 2010 numri i kërkesave është rritur shumë pra janë 10,685 kërkesa të shqyrtuara. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 6530 kërkesa ose 95.24%.

Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 95.24% të kërkesave në vitin 2011 janë shqyrtuar 90.27% të kërkesave të qytetarëve.

Numri i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

1 Zyra e Kryetarit - ka pranuar 1011 kërkesa të shqyrtuara 606 të shqyrtuara 405

2 Drejtoria për Administratë - janë pranuar 4738 kërkesa, të shqyrtuara 4722, ndërsa të shqyrtuara janë 16.

3 Drejtoria për Buxhet dhe Financa - janë pranuar 131 kërkesa, të shqyrtuara janë gjithsej 42, të shqyrtuar janë 89.

4 Drejtoria për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 294 kërkesa, të shqyrtuara janë 246, të shqyrtuara janë 48.

5 Drejtoria për Arsim - janë pranuar 222 kërkesa të shqyrtuar 206 të shqyrtuara 16.

6 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 607 kërkesa të shqyrtuar 595 të shqyrtuara 12.

7 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar 96 kërkesa, të shqyrtuar 84 të shqyrtuara 12.

8 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 146 kërkesa, të shqyrtuara janë 141 kurse të shqyrtuara janë 5 kërkesa.

9 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - janë pranuar 1751 kërkesa, janë shqyrtuar 1472 të shqyrtuara janë 279.

10 Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari - janë pranuar 67 kërkesa, të shqyrtuara janë 61, ndërsa nuk janë shqyrtuar vetëm 6 kërkesë.

11 Drejtoria e Prokurimit - janë pranuar 156 kërkesa, të shqyrtuara 121 të shqyrtuara 35.

12 Drejtoria e Inspektionit - janë pranuar 912 kërkesa, janë shqyrtuar gjithsej 907, të shqyrtuara 5 kërkesa.

13 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - janë pranuar 44 kërkesa, janë shqyrtuar 9 të shqyrtuara 35.

14 Drejtoria për Shërbime Publike - janë pranuar 508 kërkesa, janë shqyrtuar 434, të shqyrtuara janë 74.

32

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka qenë funksional gjatë kësaj periudhe dhe ka respektuar dispozitat ligjore për mbajtjen e mbledhjeve. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-ve të ndryshme, mjeteve të informimit si dhe e qytetarëve të interesuar. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunës.

Rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita po ashtu edhe nga pozita, për pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin, por ajo çka është vërejtur në këto mbledhje ka qenë mos prania e ekzekutivit të komunës.

10.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Lipjanit të ndryshoj dhe plotësoj Statutin e Komunës.**
- **Komuna e Lipjanit të merr për bazë shkresën e dërguar nga MAPL për emërimin e 2 nënkryetarëve nga komuniteti shumicë.**

Sa i përket raportimit Kryetari i Komunës ka raportuar para anëtarëve të kuvendit 2 herë duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ndërsa tubime publike kjo komunë gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 6 tubime.

Kjo komunë ende vazhdon të ketë funksionale 13 drejtori të cilat nuk parashihen me Statut të Komunës, po ashtu edhe dy nënkryetarë të emëruar nga komunitet shumicë.

Efikasiteti i organeve të administratës gjatë kësaj periudhe, është treguar mjaft efikas në realizimin e kërkesave të qytetarëve.

KOMUNA E PRISHTINËS

33

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Prishtinës ka një sipërfaqe prej 572 km². Komuna e Prishtinës, ka mbi 470.000 banorë.

Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 51 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është trembëdhjetë drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 719.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka mbajtur 12 mbledhje, për deri sa në vitin paraprak atë të 2010 ka mbajtur 13 mbledhje.

Edhe në këtë vit mbledhjet e kuvendit kanë qenë transparente për publikun, ku në ato mbledhje është vërejtur prezenca e medieeve, monitoruesve nga OSBE-ja dhe qytetarë të interesuar. Vlen të përmendet se në këto mbledhje ç`do herë kanë qenë të pranishëm ekzekutivi i komunës, të cilët kanë qenë të gatshëm të përgjigjen në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe kohore kanë funksionuar edhe trupat e Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politike dhe Financa ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 13.

Gjatë vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka qenë aktiv në miratimin e akteve të komunës duke miratuar 37 vendime dhe 3 rregullore.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të gjitha bashkësive në një komunë, ky këshill mban jo më pak se 10 takime në vit.

Në Komunën e Prishtinës, KKSB ka qenë funksionale gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Ky Këshill ka mbajtur 9 mbledhje dhe në kuadër të tyre ka pasur një aktivitet të shtuar me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me parandalimin dhe luftimin e krimit, si dhe shtimin e sigurisë në përgjithësi .

Krahasimi me vitin paraprak

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010 gjendja e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të kuvendit është e njëjtë.

Sa i përket Komiteteve Obligative, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 12 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 13 mbledhje të Komitetit për Komunitete, krahasuar me vitin 2010 ku KPF ka mbajtur 9 dhe KK 12. Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parashihet Ligji për Vetëqeverisje Lokale por janë funksionale komitete tjera. Gjatë vitit 2011 Kuvendi i Komunës e Prishtinës ka qenë aktive në miratimin e akteve të komunës, dhe janë miratuar 37 vendime dhe 3 rregullore, për deri sa në vitin 2010 ka miratua 39 vendime dhe 10 rregullore, shumica e këtyre rregulloreve janë harmonizuar me ligjet në fuqi.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Prishtinës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura në Komunën e Prishtinës është 22148, prej të cilave janë shqyrtuar 19761 ose 89.22 %.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 25019, në vitin 2011 numri i kërkesave është 22148. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 ishte 22946 ose 91.71%. Nga kjo konstatohet se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 91.71% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 89.22%.

Numri i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

1 Drejtoria për Administratë - janë pranuar 2419 kërkesa, të shqyrtuara 2108 të shqyrtuara 311.

2 Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 2901 kërkesa ,gjithsej 2372 janë shqyrtuar, ndërsa të pa shqyrtuara janë 529.

3 Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 1136 kërkesa, të shqyrtuar gjithsej 782, të shqyrtuara 354

11.1

SHKELJET E KONSTATUARA

Gjatë periudhës raportuese, është evidentuar se Komuna e Prishtinës ka mbyllur për publikun mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa. MAPL ka konstatuar se një veprim i tillë bie në kundërshtim me parimet e transparencës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren për Transparencë. Me këtë rast, Ministria ka bërë shkresën me të cilën ka kërkuar që mbledhje e KPF-së duhet të jenë të hapura në të gjitha takimet dhe të respektohet Rregullorja për Transparencë e Komunës së Prishtinës.

4 Drejtoria për Arsim - janë pranuar 789 kërkesa, gjithsej janë shqyrtuar 740 të shqyrtuara 49.

5 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 1105 kërkesa gjithsej të shqyrtuara 605 ndërsa të shqyrtuar janë 500.

6 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mbrojtje dhe Shpëtim - janë pranuar 1058 kërkesa gjithsej 1020 të shqyrtuara, të shqyrtuara 38

7 Drejtoria për infrastrukturë Lokale - janë pranuar gjithsej 585 kërkesa, gjithsej 584 të shqyrtuara ndërsa të shqyrtuar 0 Drejtoria për Financa dhe Pronë - janë pranuar 3925 kërkesa, gjithsej të shqyrtuara 3738, të shqyrtuara 187

8 Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - janë pranuar 475 kërkesa, gjithsej 460 të shqyrtuara , lëndë të pa shqyrtuara 15.

9 Drejtoria e Inspektionit - 3502 kërkesa janë pranuar , gjithsej 3440 kërkesa janë shqyrtuar ndërsa lëndët që ende nuk janë shqyrtuar janë 62.

10 Drejtoria e Kadastrit - janë pranuar 4253 , gjithsej 3912 të shqyrtuar ndërsa të pa shqyrtuara 34

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Prishtinës

Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka qenë efikas në mbajtjen e mbledhjeve, ato kanë qenë transparente për publikun ku është vërejtur prezenca e qytetarëve, monitoruesve të OSBE – së, ekzekutivi i komunës si dhe media të shumta. Gjatë kësaj periudhe është ndryshuar dhe plotësuar Statuti i Komunës së Prishtinës, ku është rritur numri i drejtorive nga 11 sa kishte në 13. Po ashtu janë ndryshuar edhe emërtimet e disa zyrave të komunës duke u harmonizuar me udhëzimet administrative të dala nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Duke iu shmangur konfliktit të interesit, duhet cekur se në Komunën e Prishtinës gjatë kësaj periudhe, ka dhënë dorëheqje Drejtoresha e Shëndetësisë, për arsye të zgjedhjes së saj si deputete në Parlamentin e Kosovës.

Po ashtu, edhe njëri nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, ka ofruar dorëheqjen, për arsye se është zgjedhur drejtor në një ndërmarrje publike.

Gjatë kësaj periudhe kuvendi është treguar mjaft efikas në miratimin e akteve të komunës, një vëmendje i është kushtuar edhe miratimit të disa raporte të ndërmarrjeve publike, si dhe miratimit të Statuteve të ndryshme si : Teatrit të Qytetit, të Qendrës së Mjekësisë Familjare, Arkivit të Komunës etj.

Në Komunën e Prishtinës mbledhjet e Komitetit për Politike dhe Financa nuk kanë qenë të hapura për publikun që nga viti i 2010 deri në maj të vitit 2011. Në lidhje me këtë, janë evidente dhe reagimet e medieve të shkruara dhe shoqërisë civile për mospërfshirjen e tyre në mbledhjet e këtij Komiteti.

Sipas kësaj rezulton që është bërë shkelje e legjislacionit në fuqi lidhur me transparencën e organeve komunale. Çështja në fjalë është e rregulluar me dispozitat ligjore dhe nënligjore, të paraqitura në vijim:

Sipas nenit 45.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale “Takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion”. Ndërkohe, me Udhëzimin Administrativ Nr.2008/03 për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ

2006/03 “Për transparencën në Komunë”, në nenin 3, paragrafi 1 thuhet “Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjen që është objekt diskutimi”.

Neni 5 i Rregullores për Transparencë të Komunës së Prishtinës thekson se “Mbledhjet e Komitetit për Politike dhe Financa janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik”.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka reaguar pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria civile për hapjen e komiteteve. Komuna ka marrë për bazë rekomandimet e ministrisë dhe nga muaji maj i vitit 2011 Komiteti për Politik dhe Financa është hapur. Po ashtu gjatë kësaj periudhe Kryetari i Komunës ka raportuar 2 herë para anëtarëve të kuvendi duke respektuar kështu një nga dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku parashihet që kryetari raportoje para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës.

Sa i përket funksionimit të organeve të administratës gjatë kësaj periudhe kjo komuna është treguar mjaft efikas sa i përket realizimit të kërkesave të qytetarëve.

11.2

REKOMANDIME

- Komuna e Prishtinës t’i përmbahet dispozitave ligjore për transparencë në Komuna.
- Komuna e Prishtinës të respektoj dispozitat ligjore sa i përket takimeve publike.

KOMUNA E PODUJEVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Podujevës, ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, për derisa në vitin 2010 ka mbajtur 11 të rregullta dhe 1 jashtëzakonshme.

Mbledhjet e kuvendit kanë qenë transparente për publikun, edhe në këtë komunë për çdo mbledhje vërehet prezenca e ekzekutivit të komunës. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunës.

Po ashtu, sa i përket transparencës duhet të përmendet kjo komunë ku informimi i qytetarëve bëhet edhe përmes shpalljeve në bashkësitë lokale.

Edhe trupat e Kuvendit të Komunës, kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohore, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 28 vendime dhe 6 rregullore.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, kurse komitetet e tjera janë funksionale.

KKSB si trup konsultues për sigurinë në vend, i rregulluar edhe me Udhëzimin Administrative NR.08/2009 MPB-02/2009 MAPL, mban jo më pak se 10 takime në vit.

Gjatë kësaj periudhe ky këshill ka mbajtur vetëm 5 takime.

Informacion i përgjithshëm

Territori i komunës së Podujevës është me një sipërfaqe prej 633 km².

Komuna e Podujevës, ka mbi 130.000 banorë.

Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 41 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 10, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 258.

Numri i drejtorive në këtë Komunë është 10, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 258.

Krahasimi me vitin paraprak

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010 gjendja e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit është e njëjtë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 10 mbledhje të Komitetit për Komunitete, krahasuar me vitin 2010 ku KPF dhe KK kanë mbajtur nga 8 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 28 vendime dhe 6 rregullore. Gjendje e njëjtë paraqitet edhe në vitin 2010.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Podujevës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Podujevës është 2044 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 1231 ose 60.22 %.

Krahasuar me vitin 2010 ku numri i kërkesave ishte 5650, në vitin 2011 numri i kërkesave të pranuar është 2044. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 ishte 5565 ose 98.49%. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 98.49% të kërkesave në vitin 2011 kjo përqindje është 60.22%.

Numri i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

1 Zyra e Kryetarit - ka pranuar 55 kërkesa të shqyrtuara 0 të shqyrtuara 55

2 Drejtorja për Administratë - janë pranuar 10 kërkesa, të shqyrtuara 0, të

pashqyrtuara 10 .

3 Drejtorja për Buxhet, Financa, Planifikim dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 256 kërkesa, të shqyrtuara 257 lëndë, të shqyrtuara janë 3.

4 Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - të pranuar 195 kërkesa, të shqyrtuara 51, ndërsa të shqyrtuara 144.

5 Drejtorja për Arsim - janë pranuar 345 kërkesa, të shqyrtuara 21 të shqyrtuara 324.

6 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 216 kërkesa, të shqyrtuara 170, ndërsa të shqyrtuara 46.

7 Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar 15 kërkesa dhe asnjëra prej tyre nuk është shqyrtuar.

8 Drejtorja e Inspeksionit - janë pranuar 105 kërkesa, të shqyrtuara 100, të shqyrtuara 5.

9 Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë - ka pranuar 145 kërkesa, të shqyrtuara 113 kërkesa, të shqyrtuara 32.

10 Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - është pranuar 472 kërkesë të shqyrtuara 467 të shqyrtuara 5.

11 Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje dhe Shpëtim - janë pranuar 2 kërkesa, të shqyrtuara 0 të shqyrtuara 2

12 Udhëheqësi i Personelit - ka pranuar 156 kërkesa të shqyrtuara 49 të shqyrtuara 107.

13 Departamenti i Prokurimit - 72 kërkesa ka pranuar, të shqyrtuara 3 të shqyrtuara 69.

38

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Podujevës

Komuna e Podujevës, gjatë kësaj periudhe ka funksionuar normalisht, mbajtja e mbledhjeve është zhvilluar brenda dinamikës së paraparë, ashtu siç parashihet me LVL. Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna, janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së.

Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt politik të mos merr pjesë në punën e kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendeve të Komunave është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita, për ato pika të rendit të ditës të cilat kanë qenë më me prioritet për qytetarin.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës së Podujevës ka raportuar vetëm një herë para anëtarëve të kuvendit., ndërsa komuna ka mbajtur 2 tubime publike gjatë kësaj periudhe.

Në këtë vit, Komuna e Podujevës ka miratuar

12.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Podujevës, të respektoj dispozitat ligjore sa i përket raportimit të Kryetarit të Komunës para anëtarëve të kuvendit.**

vendimin, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës i cili është në fazën e diskutimit publik. Ky ndryshim ka të bëjë me themelimin e Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim, si dhe me ndërrimin e emërimit të zyrës komunale për komunitet, ashtu siç parashihet me Udhëzimin Administrativ.

Komuna e Podujevës, nuk ka pasur plane zhvillimore komunale të miratuara, në këtë vit kjo komunë ka filluar hartimin e këtyre planeve të cilat janë në diskutim publik.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Podujevës, për periudhën një vjeçare ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje të dokumenteve zyrtare e cila është trajtuar nga ekzekutivi.

Edhe organet e administratës në këto komuna janë treguar mjaft efikase në pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.

KOMUNA E FERIZAJT

Informacion i përgjithshëm

Kjo komunë përbëhet prej 44 fshatrave me qendër në Ferizaj, me një sipërfaqe prej 345 km². Komuna ka një popullsi prej rreth 160.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është dhjetë (10), ndërsa numri aktual i stafit, i lejuar në administratën komunale është 299.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe edhe trupat e kuvendit kanë funksionuar normalisht ku gjatë vitit 2011 Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 13 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 7 mbledhje. Kuvendi i Komunës ka miratuar 37 vendime dhe 1 rregullore. Vendimet e miratuara në Kuvend janë të rëndësishme dhe me karakter të interesit të përgjithshëm.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe në Komunën e Ferizajt ka pasur 35 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, për 27 kërkesa është lejuar qasja në dokumentet e kërkuara, ndërsa 8 janë refuzuar.

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka funksionuar normalisht duke mbajtur 7 mbledhje.

Komuna e Ferizajt e ka të miratuar propozim buxhetin komunal për vitin 2012 brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Komuna e Ferizajt ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të Kuvendit, pra gjithsejtë me 11 mbledhje të mbajtura. Gjatë vitit 2011, KPF ka shtuar dinamikën e punës duke mbajtur 13 mbledhje, kurse në vitin 2010 ky komitet ka mbajtur 11 mbledhje. Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2010 ka mbajtur 11 mbledhje krahasuar me vitin 2011, ku numri i mbledhjeve figuron të jetë vetëm 7.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka qenë më aktiv gjatë vitit 2011 duke miratuar numër më të madh të akteve komunale me gjithsejtë 37 vendime dhe 1 rregullore, krahasuar me vitin paraprak të 2010, ku Kuvendi kishte miratuar 32 vendime dhe 1 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Ferizajt

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 20800 kërkesa, ndërsa prej tyre, të shqyrtuara janë 19934 kërkesa ose 95.83%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 12530 në vitin 2011 numri i kërkesave është 20800. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 11962 ose 95,46 % . Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 95,46% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 95,83%.

Komuna e Ferizajt ka ofruar informata për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit - janë pranuar 165 kërkesa , te shqyrtuara janë 41 kërkesa ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 24 kërkesa.

2 Drejtorja për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 11991 kërkesa, të shqyrtuara 11964 ndërsa të pashqyrtuara janë 27 kërkesa.

3 Drejtorja për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar 3751 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 3182 kërkesa, ndërsa 569 janë ende të pashqyrtuara.

4 Drejtorja për Arsim: janë pranuar 11991 kërkesa, të shqyrtuara janë 11964 ndërsa 27 nuk janë shqyrtuar ende.

5 Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet: janë pranuar 695 kërkesa. Prej

tyre janë shqyrtuar 659 kërkesa ndërsa 36 ende nuk janë të shqyrtuara.

6 Drejtorja për Planifikim dhe Zhvillim: ka pasur gjithsej 223 kërkesa, të shqyrtuara janë 223 kërkesa, te gjitha janë shqyrtuar.

7 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar 392 kërkesa ndërsa të shqyrtuara janë 391 kërkesa të shqyrtuar ndërsa 1 kërkesë nuk është shqyrtuar ende.

8 Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: ka pasur gjithsej 36 kërkesa, prej tyre 34 kërkesa janë të shqyrtuara, ndërsa 2 ende nuk janë shqyrtuara.

9 Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport: ka pasur gjithsej 268 kërkesa të shqyrtuara janë 257 ndërsa 11 nuk janë shqyrtuar ende.

10 Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë: ka pasur gjithsej 606 kërkesa, të shqyrtuar janë 600 kërkesa ndërsa 6 nuk janë shqyrtuar ende .

11 Drejtori për pune inspektuese: ka pasur gjithsej 821 kërkesa, të shqyrtuara 819 kërkesa, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 2 kërkesa.

12 Zyra e prokurimit: ka pasur gjithsejtë 896 kërkesa, janë shqyrtuar te gjitha kërkesat.

13 Zyra komunale e Komuniteteve: ka pasur gjithsej 12 kërkesa, 11 janë shqyrtuar ndërsa 1 kërkesa nuk është shqyrtuar ende.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Ferizajt

Komuna e Ferizajt, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht si dhe në përputhje me statutin e komunës dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kuvendi i komunës ka qenë aktiv në mbajtjen e seancave si dhe miratimin e akteve

komunale, mbledhjet kanë qenë transparente ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e OSBE-së si dhe OJQ e qytetarë të interesuar për të marre pjesë në mbledhje.

Ftesa si dhe materiali përcjellës për mbajtjen e seancës në MAPL- janë dërguar më kohë.

Vështirësi në punën e kuvendit është sepse kërkesat si dhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit shumë kohe mbesin pa përgjigjeje pasi që ekzekutivi i neglizhon përgjigjeje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit 2 herë si dhe ka paraqitur raportin financiar të ekzekutivit para Kuvendit sa herë që ka qenë e nevojshme.

Komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë.

13.1

41

REKOMANDIME

- **Ekzekutivi i komunës të jetë më aktiv në kërkesat dhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit dhe tu përgjigjet më kohë pyetjeve dhe kërkesave të tyre.**

Efikasiteti i organeve komunale gjatë kësaj periudhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve ka qenë mjaft aktiv ku janë shqyrtuar 95.83% të kërkesave të paraqitura nga qytetarët pranë organeve të administratës komunale.

14

KOMUNA E KAÇANIKUT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Kaçanikut, ka një sipërfaqe prej 306 km² dhe një popullsi prej rreth 33.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 27 anëtarë. Numri i drejtorive është shtatë (7), ndërsa numri i stafit të lejuar të administratës komunale është 128.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe Komitetit për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete edhe pse i themeluar nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për këtë periudhë.

Në periudhën e vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka miratuar 33 vendime dhe 3 rregullore. Vlen të theksohet se Kuvendi ka miratuar Rregulloren për transparencë komunale, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL është kërkuar që Kuvendi i Komunës të rishqyrtoj edhe një herë këtë Rregullore më qëllim të harmonizimit të saj me ligjet e Republikës së Kosovës. Këtë Rregullore Kuvendi i Komunës së Kaçanikut e ka rishqyrtuar dhe e ka harmonizuar sipas rekomandimeve të MAPL-së.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe kemi pasur 75 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare .

Komuna e Kaçanikut ka miratuar propozim Buxhetin Komunal për vitin 2012 brenda afatit ligjor të

përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë vitit 2011 ka qenë më aktiv në mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit me gjithsej 11 mbledhje, përderisa gjatë vitit 2010 kishte mbajtur 10 mbledhje. KPF është treguar më aktive gjatë kësaj periudhe ku ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka funksionuar dhe se kjo çështje mbetet sfidë e komunës për të bërë funksionalizimin e komitetit në fjalë.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, ka miratuar numër të njëjtë të vendimeve, pra nga 33 vendime si në vitin 2010 ashtu edhe në vitin 2011. Ndërsa në nxjerrjen e rregulloreve, Kuvendi ka miratuar më shumë rregullore, ku gjatë vitit 2010 ka miratuar 7 rregullore ndërsa në vitin 2011 ka miratuar vetëm 3 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Kaçanikut

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 18045 kërkesa, prej të cilave 13887 kërkesa ose 76,95% prej tyre janë shqyrtuar.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 5447 në vitin 2011 numri i kërkesave është 18045. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 5397 ose 99,08% . Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 99,08% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 76,95%.

Komuna e Kaçanikut ka ofruar informata për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit: janë pranuar 908 kërkesa janë shqyrtuar 448 kërkesa ndërsa ende

nuk janë shqyrtuar 460 kërkesa.

2 Drejtorja për Administratë dhe Personel: janë pranuar gjithsej 10839 kërkesa, të shqyrtuara 8166 kërkesa ndërsa 2673 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

3 Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: janë pranuar gjithsej 429 kërkesa, të shqyrtuara 204 kërkesa, ndërsa 225 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

4 Drejtorja për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar gjithsej 4389 kërkesa, të shqyrtuara janë 4330 kërkesa, ndërsa 59 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

5 Drejtorja për Arsim dhe Kulturë: janë pranuar 607 kërkesa, të shqyrtuara 152 ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 455 kërkesa.

6 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar 143 kërkesa, të shqyrtuara 93 ndërsa e pa shqyrtuar 50 kërkesa.

7 Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: janë pranuar 440 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 331 kërkesa, ndërsa 109 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

8 Drejtorja për Emergjencë dhe Shërbime Publike: janë pranuar 290 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara 163 kërkesa, ndërsa 127 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Kuvendi i komunës ka qenë aktiv në mbajtjen e seancave si dhe miratimin e akteve komunale, mbledhjet kanë qenë transparente ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e OSBE-së si dhe OJQ e qytetarë të interesuar për të marre pjesë në mbledhje. Vlen të theksohet se Kuvendi ka miratuar

Rregulloren për transparencë komunale, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL është kërkuar që Kuvendi i Komunës të rishqyrtoj edhe një herë këtë Rregullore më qëllim të harmonizimit të saj me ligjet e Republikës së Kosovës. Këtë Rregullore Kuvendi i Komunës së Kaçanikut e ka rishqyrtuar dhe e ka harmonizuar sipas rekomandimeve të MAPL-së. Në komunën e Kaçanikut KK nuk ka mbajtur asnjë mbledhje gjatë kësaj periudhe edhe pse është formuar si trup i kuvendit Kryetari i komunës përpos raportit që ka paraqitur para kuvendit në mbledhjet tjera nuk ka qenë i pranishëm, ndërsa drejtoret e drejtorive si dhe nënkryetari kanë qenë aktivë gjatë seancave. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi më gjithë vështirësitë që kishte në fillim pasi Kryetari i komunës pezulloj punën e këtij

14.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Kaçanikut të funksionalizoj komitetin për komunitete.**

këshilli, pas ndërhyrjes nga MPB dhe MAPL, është arritur që KKSB të funksionalizohet prapë dhe ka funksionuar normalisht pa ndonjë problem. Komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë. Efikasiteti i organeve komunale gjatë kësaj periudhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve ka qenë aktiv ku janë shqyrtuar 76.95% të kërkesave të paraqitura nga qytetarët pranë organeve të administratës komunale.

43

15

KOMUNA E SHTIMES

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km². Komuna e Shtimes ka mbi 29.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 21 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 7, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 74.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e Kuvendit të Komunës kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohore, ku Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 12 mbledhje.

Sa i përket akteve të miratuara në Kuvend, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar 63 vendime dhe 7 rregullore.

Lidhur me qasjen e dokumenteve zyrtare, Komuna e Shtimes për periudhën një vjeçare nuk ka pranuar ndonjë kërkesë të tillë, si dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë apo peticion.

Në Komunën e Shtimes, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka funksionuar normalisht dhe ka mbajtur 8 mbledhje.

Komuna e Shtimes e ka të miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 brenda afateve ligjore si dhe listën e

projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë për vitin 2012.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar më vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur numër më të madh të mbledhjeve gjatë vitit 2011. Përderisa gjatë 2010 ka mbajtur 11 mbledhje të Kuvendit, në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje. Ndërsa trupat e Kuvendit kanë qenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2010 ka mbajtur 9 mbledhje, kurse gjatë vitit 2011 ka mbajtur 12 mbledhje. Gjithashtu edhe Komiteti për Komunitete në vitin 2010 ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje.

Po ashtu edhe në miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Shtimes në vitin 2011 ka qenë më aktiv duke miratuar 63 vendime dhe 7 rregullore, kurse në periudhën e vitit 2010 ka miratuar 24 vendime dhe 4 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Shtimes

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 2306 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 2149 ose 93.19%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 5152 në vitin 2011 numri i kërkesave është 2306. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 5152 ose 99,09 % . Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 99.09% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 93,19%.

Komuna e Shtimes ka ofruar informata për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit: janë pranuar 71 kërkesa, janë shqyrtuar 7 kërkesa, ndërsa te pa shqyrtuara kanë mbetur 64 kërkesa.

2 Drejtorja për Administratë dhe Personel: janë pranuar gjithsej 1050, të shqyrtuara janë te gjitha.

3 Drejtorja për Planifikim urban kadastër dhe gjeodezi: janë pranuar gjithsej 798 kërkesa, të shqyrtuara 794, ndërsa të pashqyrtuara janë 04 kërkesa.

4 Drejtorja për Ekonomi dhe Financa: janë pranuar gjithsej 100 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

5 Drejtorja për Arsim dhe Kulturë, Rini dhe Sport: janë pranuar 69 kërkesa, të shqyrtuara 28 ndërsa 41 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

6 Drejtorja për shërbime publike: ka pasur gjithsej 117 kërkesa te shqyrtuara janë 82 kërkesa ndërsa 35 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

7 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Mbrojtje dhe Emergjencë: janë pranuar gjithsej 96 kërkesa, të shqyrtuara 88 kërkesa, të pashqyrtuara 8 kërkesa.

8 Drejtorja për mbrojtje dhe shpëtim: ka pranuar 5 kërkesa dhe nuk ka shqyrtuar asnjë nga to.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Shtimes

Komuna e Shtimes, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht dhe nuk ka pasur ndonjë pengesë gjatë kësaj periudhe.

Kuvendi i komunës ka qenë aktiv në mbajtjen e seancave si dhe miratimin e akteve komunale, mbledhjet kanë qenë transparente ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e OSBE-së si dhe OJQ e qytetarë të interesuar për të marre pjesë në mbledhje.

Ftesa si dhe materiali përcjellës i cili ka pasur për tu shqyrtuar në seancë janë dërguar më kohë në MAPL- janë dërguar më kohë.

Kryetari i komunës ka qenë aktiv gjatë mbajtjes së seancave ku ka marrë pjesë po thuajse në të gjitha seancat e kuvendit që janë mbajtur gjatë kësaj periudhe duke u përgjigjur edhe në pyetjet apo kërkesat që janë ngritur nga anëtarët e kuvendit por

drejtorët e drejtorive nuk kanë marrë pjesë në mbledhje pra shumë herë është vërejtur mungesa e tyre në seanca.

Kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit 2 herë si dhe ka paraqitur raportin financiar të ekzekutivit para Kuvendit sa herë që ka qenë e nevojshme.

Komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë.

Efikasiteti i organeve komunale gjatë kësaj periudhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve ka qenë mjaft aktiv ku janë shqyrtuar 93.19% të kërkesave të paraqitura nga qytetarët pranë organeve të administratës komunale.

15.1

REKOMANDIME

- Në Komunën e Shtimes, drejtorët e drejtorive të jenë më aktiv në mbledhjet e kuvendit.

16

KOMUNA E SHTRËPCËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Shtërpcës ka mbi 13.630 banorë. Kuvendi i Komunës ka një përbërje prej 21 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në Komunën e Shtërpcës është 8, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 69.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur 10 mbledhje, nga to 7 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Trupat e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, më konkretisht Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 6 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 9 mbledhje.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit pasi që është zgjedhur në pozitën e drejtorit të spitalit të Shtërpcës, kurse në vend të tij është zgjedhur z. Predrag Gerbiq.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2011 ka miratuar 23 vendime dhe 2 rregullore.

Lidhur me qasjen e dokumenteve zyrtare, Komuna e Shtërpcës për periudhën një vjeçare nuk ka pranuar ndonjë kërkesë të tillë.

Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Shtërpcës ka

pasur ndryshime në ekzekutiv. Dy nga drejtorët kanë dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit duke eliminuar mundësinë për mbajtje të pozitave të dyfishta. Njëri nga drejtorët është zgjedhur deputet në parlamentin e Kosovës, ndërsa tjetri është emëruar Ministër në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete.

Në Komunën e Shtërpçës është krijuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, por nuk ka qenë funksional gjatë vitit 2011 ngase nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Komuna e Shtërpçës ka miratuar propozim buxhetin brenda afateve ligjore si dhe listën e projekteve prioritare për investime kapitale të Komunës për vitin 2012

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar më vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve, pra nga 10 mbledhje. Ndërsa Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2011 ka mbajtur 1 mbledhje më shumë se në vitin 2010, pra gjithsej 6 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka qenë më aktiv gjatë vitit 2011 dhe ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa gjatë vitit 2010 ka mbajtur vetëm 5 mbledhje.

Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës gjatë vitit 2011 ka miratuar numër më të vogël të akteve komunale. Deri sa në vitin 2010, Kuvendi ka miratuar 27 vendime dhe 8 rregullore, gjatë vitit 2011 ky Kuvend ka miratuar 23 vendime dhe 2 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Shtërpçës

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 3421 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 2789 ose 81.52%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 824 në vitin 2011 numri i kërkesave është

3421. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 809 ose 98,17 %. Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 98,17% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 81,52%.

Komuna e Shtërpçës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit ka pranuar 1518 kërkesa të shqyrtuara janë 1033 kërkesa ndërsa nuk janë shqyrtuar ende 485 kërkesa

2 Drejtoria për Administratë dhe Personel – Në këtë drejtori janë pranuar 292 kërkesa, të shqyrtuara janë 289, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

3 Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Në këtë drejtori janë pranuar 392 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha,

4 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Turizëm, Bujqësi dhe Pylltari - Në këtë drejtori janë pranuar 62 kërkesa janë shqyrtuar 53 kërkesa ndërsa 9 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende. Kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 20, ndërsa 4 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

5 Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit - Në këtë drejtori janë pranuar 485 kërkesa, të shqyrtuara janë 414, ndërsa 73 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

6 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Prone - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 349 kërkesa, të shqyrtuara janë 296, ndërsa 53 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende

7 Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 160 kërkesa, të shqyrtuara janë 155, ndërsa nuk janë shqyrtuar ende 5 kërkesa .

8 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Në këtë drejtori janë pranuar 117 kërkesa, të shqyrtuara janë 116 kërkesa, ndërsa ende nuk është shqyrtuar 1 kërkesë.

9 Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - Në këtë drejtori janë pranuar 46 kërkesa, ku 34 kërkesë janë shqyrtuar ndërsa 2kërkesa ende nuk janë shqyrtuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Shtërpcës

Komuna e Shtërpcës, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht si dhe në përputhje me statutin e komunës Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Kuvendi i komunës ka funksionuar normalisht ndërsa sa i përket miratimit të akteve komunale gjatë kësaj periudhe nuk ka treguar efikasitet të shtuar nëse e krahasojmë më vitin e kaluar.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit pasi që është zgjedhur në pozitën e drejtorit të spitalit të Shtërpcës, kurse në vend të tij është zgjedhur z. Predrag Gerbiq.

Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Shtërpcës ka pasur ndryshime edhe në ekzekutiv ku dy drejtorë kanë dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit duke eliminuar mundësinë për mbajtje të pozitave

16.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Shtërpcës të funksionalizoj Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.**

të dyfishta. Njëri nga drejtorët është zgjedhur deputet në parlamentin e Kosovës, ndërsa tjetri është emëruar Ministër në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete.

Kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit 2 herë ndërsa sa i përket pjesëmarrjes në seancat tjera që ka mbajtur kuvendi kryetari nuk ka qenë aktiv.

Komuna e Shtërpcës nuk ka funksionalizuar KKSBB edhe pse është formuar ende nuk ka arritur të mbajë asnjë takim.

Komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë.

Efikasiteti i organeve komunale gjatë kësaj periudhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve ka qenë mjaft aktiv ku janë shqyrtuar 81.52% të kërkesave të paraqitura nga qytetarët pranë organeve të administratës komunale.

47

KOMUNA E GRAÇANICËS

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Graçanicës ka një sipërfaqe prej 131.25 km². Komuna e Graçanicës ka mbi 19.392 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 19 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 7, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 59.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Graçanicës, gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka mbajtur 15 mbledhje, nga to 10 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme. Trupat e Kuvendit të Komunës kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohore. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 mbledhje.

Periudha janar – dhjetor e vitit 2011 karakterizohet me miratimin e akteve të ndryshme komunale, qoftë për nga prioritetet apo për nga rëndësia e tyre. Në këtë drejtim, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka miratuar 65 vendime dhe 8 rregullore.

Komuna e Graçanicës ende nuk e ka emëruar nënkryetarin për komunitete edhe pse kjo pozitë është e paraparë me ligj.

Sa u përket kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare, në Komunën e Graçanicës nuk ka pasur ndonjë kërkesë të tillë.

Në Komunën e Graçanicës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është formuar mirëpo nuk është funksional.

Krahasimi me vitin paraprak

Përderisa në vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur 16 mbledhje, gjatë vitit 2011 ky Kuvend ka mbajtur 15 mbledhje. Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur 1 mbledhje më pak se sa gjatë vitit 2011. Sa u përket mbledhjeve të KPF dhe KK mungojnë të dhënat e vitit 2010 dhe në këtë çështje nuk mund të bëjmë krahasimin me të dhënat e vitit 2011.

Kuvendi i Komunës së Graçanicës, gjatë vitit 2011 ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale. Përderisa në vitin 2010, Kuvendi ka miratuar 37 vendime dhe 5 rregullore, gjatë vitit 2011, ky Kuvend ka miratuar 65 vendime dhe 8 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Graçanicës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Graçanicës për periudhën janar- dhjetor 2011 është 13757, të shqyrtuara janë 13397 ose 97.38 % .

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 3396 në vitin 2011 numri i kërkesave është 13757. Kurse, sa iu përket kërkesave të

shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 3396 ose 100 % të kërkesave edhe të dhënat që janë prezantuar nga komuna kanë qenë vetëm kërkesat e shqyrtuara e jo edhe ato të pa shqyrtuara. Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 100 % të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 97.38%.

Komuna e Graçanicës ka ofruar të dhëna për 7 drejtori:

1 Drejtorja e Administratës – Në këtë drejtori janë pranuar 369 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha.

2 Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe zhvillim ekonomik - Në këtë drejtori janë pranuar 4698 kërkesa, të shqyrtuara janë 4680, ndërsa 18 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

3 Drejtorja për planifikim Urbanizëm dhe Kadastër dhe mbrojtje të mjedisit - Në këtë drejtori janë pranuar 6130 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 5797, ndërsa 333 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

4 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Në këtë drejtori janë pranuar 406 kërkesa, 403 janë të shqyrtuara ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

5 Drejtorja për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 204 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

6 Drejtorja për Shërbime Publike, bujqësi, pylltari, mbrojtje dhe shpëtim - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 1898 kërkesa, ku të gjitha kërkesat janë shqyrtuar.

7 Drejtorja për Inspektorat - Në këtë drejtori janë pranuar 52 kërkesa të shqyrtuara janë 46 ndërsa 6 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Të dhënat për efikasitetin dhe azhuritetin e Komunës së Graçanicës janë marrë nga Drejtori i administratës pasi që kjo komunë

17.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

- Megjithëse në komunën e Graçanicës komuniteti pakicë është në më shumë se 10%, kryetari i komunës nuk ka ndër marrë veprime për të emëruar nënkryetarin e komunës për komunitete. Sipas LVL komunitat që kanë mbi 10% të komunitetit pakicë janë të obliguar që të emërojnë nënkryetarin e komunës.
- Komuna e Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, duke mos respektuar dispozitat që përcaktojnë kohëzgjatjen e dhënies në shfrytëzim, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme komunale . Pas kërkesës së MAPL-së për të rishqyrtuar këtë vendim, Kuvendi i Komunës ka zbatuar rekomandimin e Ministrisë.

50

ende nuk e përdor softuerin e vendosur në Komunë nga MAPL.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës Graçanicës

Komuna e Graçanicës për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht por ende nuk ka emëruar nënkryetarin për komunitete pozitive kjo e paraparë sipas LVL-së.

Kuvendi i komunës ka funksionuar normalisht edhe sa i përket miratimit të akteve komunale gjatë kësaj periudhe ka treguar efikasitet në miratimin e akteve komunale.

Ftesat për mbledhje të Kuvendit dërgohen nga komuna e Graçanicës në MAPL por jo edhe materiali i cili do të shqyrtohet gjatë seancës ku komuna ka vështirësi në përkthimin e dokumenteve dhe shpesh herë materialet dërgohen vetëm në gjuhën serbe. Kryetari i komunës ka raportuar para kuvendit 2 herë ndërsa në seancat tjera nuk ka marrë pjesëmarrje të kënaqshme.

KKSB, në Komunën e Graçanicës nuk ka mbajtur asnjë takim gjatë kësaj periudhe pra nuk ka qenë funksional.

17.2

REKOMANDIME

- Komuna e Graçanicës të emëroj nënkryetarin për komunitete konform LVL-së.
- Komuna e Graçanicës të funksionalizoj Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.
- Në Komunën e Graçanicës të funksionalizohet serveri për azhurnimin e të dhënave nga drejtoritë komunale në pranimin si dhe zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve.

Komuna ka organizuar 2 takime publike me qytetarë. Efikasiteti i organeve komunale gjatë kësaj periudhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve ka qenë mjaft aktiv ku janë shqyrtuar 81.52% të kërkesave të paraqitura nga qytetarët pranë organeve të administratës komunale.

Por vlen të theksohet se kjo komunë ende nuk e përdor serverin e dërguar në MAPL për azhurnimin e të dhënave në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve.

KOMUNA E PRIZRENIT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Prizrenit përbëhet prej 76 vendbanimeve dhe ka një sipërfaqe prej 640 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 180.000 banorë. Në komunën e Prizrenit numri i anëtarëve është 41, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 13, ndërsa numri i stafit të lejuar është 346.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka qenë i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe njëkohësisht ka treguar koherencë në funksionimin e punës së tij. Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2011 ka mbajtur 13 mbledhje të rregullta, të gjitha mbledhjet e mbajtura kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, ICO-së, KDI-së, KFOR-it, USAID-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Gjatë vitit 2011, anëtarët e kuvendit nga radhët e opozitës, pas një bojkoti disa mujorë të Kuvendit të Komunës, u janë kthyer punimeve të Kuvendit dhe kanë dalë me propozime për plotësimin e komiteteve të kuvendit më anëtarë të rinj. Në këtë drejtim është shënuar një hap pozitiv drejt normalizimit dhe funksionalizimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Në vitin 2011, kjo komunë ka emëruar edhe Avokatin Publik Komunal. Po ashtu, është miratuar edhe Rregullorja për Aplikimin e Tatimit në Pronën e Paluajtshme.

Kjo komunë edhe gjatë vitit 2011 nuk e ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.

Në mbledhjen e datës 08.09.2011 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit është shqyrtuar Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2011, miratoi vendimin për çështjen e emblemës të komunës së Prizrenit.

Në këtë komunë janë funksionale dhe komitetet obligative. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 14 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak,

atë të vitit 2010, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete kishin mbajtur nga 3 mbledhje. Gjatë kësaj periudhe janë themeluar edhe dy komitete të tjera: Komiteti për Barazi Gjinore dhe Komiteti Komunal i Banimit (KKB).

Në çështjen e miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë kësaj periudhe ka miratuar 65 vendime dhe 1 rregullore.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional në këtë komunë dhe i ka mbajtur 5 mbledhje në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Në lidhje me propozim-buxhetin, Kryetari i Komunës ka mbajtur takime publike me qytetarë për të marrë opinionet e tyre.

Krahasimi me vitin paraprak

Përderisa në vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur 7 mbledhje, gjatë vitit 2011 ky Kuvend ka mbajtur 13 mbledhje. Nga kjo rezulton se kjo komunë gjatë këtij viti ka përbushur obligimin ligjor në realizimin e mbledhjeve ashtu siç e parasheh LVL.

Tek komitetet obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 14 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak, atë të vitit 2010, KPF dhe KK kishin mbajtur nga 3 mbledhje.

Krahasuar me vitin 2010, numri i akteve të miratuara ë Kuvend ishte 32 vendime dhe 1 rregullore, ndërsa në vitin 2011 numri i akteve të miratuara është 65 vendime dhe 1 rregullore. Në krahasimin e këtyre të dhënave konstatohet se Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2011 ka miratuar numër më të madh të akteve komunale.

18.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

- **MAPL ka pranuar ankesë nga një anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim kompanisë “Kamilla sh.p.k” dhe kompanisë QEA “Gulistan”, pa respektim të procedurave të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme komunale. Pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimi, komuna është në proces të zbatimit të rekomandimeve të ministrisë.**

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Prizrenit

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat vetëm për drejtorit e kësaj komune. Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Prizrenit për periudhën janar- dhjetor të vitit 2011 është 12034, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 8386 ose marrë në përqindje rezulton të jetë 70%.

Duke krahasuar me periudhën janar- dhjetor të vitit 2010, numri i kërkesave të pranuar ishte 19656, ndërsa të shqyrtuara ishin 18931 ose marrë në përqindje 96.3%. Në periudhën janar- dhjetor të vitit 2011 numri i kërkesave të pranuar është 12034 ndërsa të shqyrtuara janë 8386 kërkesa ose marrë në përqindje 70%.

Komuna e Prizrenit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës gjatë kësaj periudhë ka pranuar 3596 kërkesa, 2826 kërkesa janë të shqyrtuara ndërsa 770 prej

tyre ende nuk janë shqyrtuar.

2 Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka pranuar 942 kërkesa , të shqyrtuara janë kërkesa 718 ndërsa 224 prej tyre ende nuk janë shqyrtuar.

3 Drejtoria për Shërbime publike ka pranuar 1270 kërkesa ,1058 prej tyre janë shqyrtuar ndërsa 212 nuk janë shqyrtuar ende.

4 Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka pranuar gjithsej 1136 kërkesa, prej tyre 558 janë shqyrtuar dhe 578 janë ende të pashqyrtuara.

5 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër gjatë kesaj periudhe ka pranuar 3850 kërkesa ,ndërsa 2430 prej tyre janë shqyrtuar, 1420 nuk janë shqyrtuar ende.

6 Drejtoria për Arsim dhe Shkencë ka pranuar 70 kërkesa, prej tyre 46 janë shqyrtuar ndërsa 24 nuk janë shqyrtuar ende.

7 Drejtoria për Shëndetësi ka pranuar 199 kërkesa,prej tyre 179 janë shqyrtuar ndërsa 20 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

8 Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm gjatë ketij viti ka pranuar 37 kërkesa, 11 prej tyre jan shqyrtuar ndërsa 26 prej tyre nuk janë shqyrtuar ende.

9 Drejtoria për Emergjenca dhe Siguri ka pranuar 69 kërkesa gjatë kesaj periudhe , prej tyre 44 janë shqyrtuar ndërsa 25 nuk janë shqyrtuar ende.

10 Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural gjatë kësaj periudhe ka pranuar gjithsej 115 kërkesa , të shqyrtuara janë 65 kërkesa, ndërsa nuk jan shqyrtuar ende 50.

11 Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport gjatë kesaj periudhe ka pranuar 249 kërkesa, prej tyre 203 janë shqyrtuar, ndërsa 46 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

12 Drejtoria për punë dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar 205 kërkesa, 200 janë shqyrtuar, ndërsa 5 prej tyre janë shqyrtuar ende.

13 Drejtoria për inspektorate ka pranuar gjithsej 296 kërkesa, 48 prej tyre janë shqyrtuar, ndërsa 248 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende .

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Prizrenit

Kuvendi i Komunë së Prizrenit gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2011 ka qenë funksionale dhe mjaftë e kënaqshme. Gjatë vitit 2011, kjo komuna kanë mbajtur gjithsej 13 mbledhje të rregullta. Në përgjithësi kjo komunë, dërgimin e ftese për mbledhje e ka dërguar me kohë. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2011 ka miratuar akte komunale me rëndësi dhe me interes për qytetarët. Në këtë drejtim janë miratuar gjithsej 65 vendime dhe 1 rregullore.

Kjo komunë edhe gjatë vitit 2011 nuk e ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.

Lidhur me efikasitetin e organeve te administratës së komunës, Komuna e Prizrenit këto të dhëna i ka ofruar përmes softuerit elektronik.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo sa here qe nje gjë e tillë kërkohet. Kryetari i Komunes se Prizrenit ka raportuar 2 here para Kuvendit të Komunës.

Kryetari i Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2011 ka mbajtur 4 takime publike me qytetarët e kësaj komune.

54

Në kuadër të aktiviteteve të komunës, Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2011 ka implementuar projektin për ndriçimin eficient të qytetit dhe të rrugëve periferike, në kuadër të ndriçimit publik të qytetit.

Po ashtu, kjo komunë gjatë vitit 2011 është binjakëzuar edhe me Komunën Kyjov në Çeki. Sa i përket politikave publike komunale, Komuna e Prizrenit e ka mbështetur zhvillimin e bujqësisë në të gjithë sektorët e saj, posaçërisht bujqit e komunës duke i subvencionuar me farëra gruri dhe fidane.

18.2

REKOMANDIME

- Rekomandoj që kjo komunë të miratoj Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.
- Komuna e Prizrenit të dërgojnë aktet e miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrin përgjegjëse ashtu siç e parasheh LVL.
- Dërgimi i ftesës dhe i materialit për mbledhje të dërgohet me kohë ashtu siç e parasheh LVL.

19

KOMUNA E SUHAREKËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Suharekës përbëhet prej 41 vendbanimeve dhe ka një sipërfaqe prej 362 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 87.500 banorë. Në Komunën e Suharekës numri i anëtarëve është 35 të cilët zgjedhën drejtpërdrejt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 9, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 154.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Në aspektin kuantitativ, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka përbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, KFOR-it, USAID-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Në këtë komunë janë funksionale edhe komitete obligative (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete). Gjatë periudhës janardhjetor të vitit 2011, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 8 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak, atë të vitit 2010, Komiteti për Politikë dhe Financa kishte mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 6 mbledhje.

Komuna e Suharekës gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 nuk ka themeluar ndonjë komitet tjetër.

Në miratimin e akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Suharekës në periudhën kohore janar – dhjetor 2011, ka miratuar 44 vendime dhe 2 rregullore.

Në Komunën e Suharekës është evi Fjuntuar një rast i konfliktit të interesit gjatë marrjes së vendimit për ndarjen e banesave për familjarët e dëshmorëve. Ndërsa, nuk është paraqitur ndonjë rast i konfliktit të interesit tek ushtrimi i pozitave të dyfishta.

Në Komunën e Suharekës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional dhe gjatë këtij viti i ka mbajtur 4 mbledhje. Ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Suharekës e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin paraprak Kuvendi i Komunës së Suharekës ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 8 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak, atë të vitit 2010, Komiteti për Politikë dhe Financa kishte mbajtur 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 6 mbledhje.

Sa i përket numrit të akteve të miratuara Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë vitit 2010 i ka miratuar 35 vendime dhe 4 rregullore, ndërsa në vitin 2011 i ka miratuar 44 vendime dhe 2 rregullore. Nga kjo rezulton se kjo komunë në vitin 2011 ka shënuar

numër më të lartë në miratimin e akteve komunale.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Suharekës

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat vetëm për drejtorit e kësaj komune.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Suharekës për periudhën janar - dhjetor të vitit 2011 është 4052, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 1993 ose marrë në përqindje rezulton në 44.26 %.

Duke krahasuar me periudhën janar- dhjetor të vitit 2010, numri i kërkesave të pranuar ishte 11948 ndërsa të shqyrtuara ishin 11929 ose marr në përqindje 99.84. Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2011 numri i kërkesave të pranuar është 4052, ndërsa të shqyrtuara janë 1993 kërkesa ose marrë në përqindje 44.26 %.

Komuna e Suharekës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratë dhe Inspektion ka pranuar gjithsej 1066 kërkesa, prej tyre jan te shqyrtuara 810 kërkesa ndërsa prej tyre nuk jan shqyrtuar ende 256.

2 Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport ka pranuar gjithsej 8 kërkesa , prej tyre jan shqyrtuar 3 , ndërsa nuk jan shqyrtuar ende 5 kërkesa.

3 Drejtoria për Arsim ka pranuar gjithsej kërkesa 492, prej tyre 198 janë te shqyrtuara ndërsa nuk jan shqyrtuar ende 284.

4 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente ka pranuar gjithsej 384 kërkesa te shqyrtuara janë 93, prej tyre nuk jan shqyrtuar ende 291.

56

5 Drejtoria për Urbanizëm Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Mjedis ka pranuar 904 kërkesa, prej tyre 121 jan shqyrtuar, ndërsa prej tyre 783 nuk jan shqyrtuar ende.

6 Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka pranuar gjithsej 1450 kërkesa, prej tyre 706 janë te shqyrtuara ndërsa 744 nuk janë shqyrtuar ende.

7 Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pyltari ka pranuar gjithsej 160 kërkesa, prej tyre jan shqyrtuar 37 ndërsa 123 nuk janë shqyrtuar ende.

8 Drejtoria për Mërgatë ka pranuar 15 kërkesa, prej tyre jan shqyrtuar 8 ndërsa 7 nuk janë shqyrtuar ende.

9 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar gjithsej 20 kërkesa, 4 prej tyre janë shqyrtuar ndërsa 16 prej tyre nuk janë shqyrtuar ende .

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Suharekës

Komuna e Suharekës gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011 në bazë të të dhënave të përfshira në raport rezulton të jetë mjaftë i kënaqshëm.

Në aspektin kuantitativ, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e seancave si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre. Numri i mbledhjeve është 12 të rregullta dhe 1 te jashtëzakonshme. Numri i akteve te miratuara në këtë komunë është 44 vendime dhe 2 rregullore.

19.1

REKOMANDIME

- **Komuna e Suharekës të dërgoj me kohë materialet e mbledhjes së Kuvendit ashtu siç e parasheh LVL.**

Lidhur me efikasitetin e organeve te administratës së komunes, Komuna e Suharekës këto të dhëna i ka ofruar përmes softuerit elektronik.

Kryetari i Komunës së Suharekës gjatë vitit 2011 ka mbajtur 2 takime publike me qytetarët e kësaj komune.

Sa i përket raportimit të kryetarit, Kryetari i Komunës se Suharekës gjatë vitit 2011 ka raportuar 4 herë para Kuvendit të Komunë, nga kjo shihet që është respektuar Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (pika 58 pika j).

Gjatë periudhës së raportimit në Komunën e Suharekës është evidentuar një rast i konfliktit të interesit gjatë marrjes së vendimit për ndarjen e banesave për familjaret e dëshmorëve.

Komuna e Suharekës gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011 ka lidhur marrëveshje për binjakëzimin e dy komunave, atë të qytetit të Fellbahut të Republikës së Gjermanisë dhe të qytetit të Suharekës të Republikës së Kosovës. Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë kesaj periudhe ka miratuar vendimin për iniciimin e procedurës për ngritjen e shtatores për veprimtarin “Fadil Vata”.

KOMUNA E MAMUSHËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Mamushës ka një sipërfaqe prej 12.4 km². Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 5.000 banorë, i përbërë me shumicën e numrit të popullsisë nga komuniteti turk. Në Komunën e Mamushës numri i anëtarëve është 15 të cilët zgjedhën drejtpërdrejt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 5, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 47.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Në përgjithësi, Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht dhe ka përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së mbledhjeve. Ky Kuvend ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit nuk është evidentuar ndonjë parregullsi, apo bojkot i mbledhjes nga ana e anëtarëve të kuvendit.

Në përgjithësi mbledhjet e kuvendit kanë qenë transparente për publikun dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues të KFOR-it, KDI-së, OSBE-së.

Edhe komitetet obligative janë funksionale në këtë komunë. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga 11 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak, atë të vitit 2010 Komiteti për Politikë dhe Financa kishte mbajtur 8 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete kishte mbajtur 2 mbledhje. Numri i akteve të miratuara gjatë këtij viti në Komunën e Mamushës është 18 vendime dhe 3 rregullore. Kjo komunë gjatë kësaj periudhe e ka miratuar Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit, Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për Vitin 2012 dhe Buxhetin e Komunës për Vitin 2012. Duke pasur parasysh që në këtë komunë nuk ka plan urbanistik është lidhur marrëveshja e mirëkuptimit me UN-HABITAT-in, ku ky projekt do të përkrahët me ndihmën teknike edhe nga Republika e Turqisë.

Edhe në këtë komunë gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit, qoftë tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, apo tek marrja e vendimeve.

Gjatë këtij viti, në Komunën e Mamushës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Krahasimi me vitin paraprak

Duke e bërë krahasimin me vitin paraprak të 2010, Kuvendi i Komunës së Mamushës ka mbajtur 10 mbledhje, kurse në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Kurse sa i përket numrit të akteve të miratuara, Kuvendi i Komunës së Mamushës në vitin 2010 ka miratuar 20 vendime dhe 6 rregullore, ndërsa në vitin 2011 ka miratuar 18 vendime dhe 3 rregullore. Nga kjo rezulton se në vitin 2011 numri i akteve të miratuara është më i ulët.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Mamushës

Në pasqyrën e mposhte janë përfshirë të dhënat vetem për drejtorit e kësaj komune. Këto të dhëna nuk janë siguruar nga softueri. Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetareve të paraqitura para organeve të administratës së Komunes së Mamushës për periudhën janar- dhjetor për vitin 2011 është 748, janë shqyrtuar 748 ose marrë në përqindje rezulton në 100% Krahasuar më periudhën janar – dhjetor 2010, ku numri i kërkesave ishte 840 prej tyre 788 janë shqyrtuar ose 93.8% kjo na tregon se gjate vitit 2011 numri i kërkesave të qytetareve ishte me i vogël.

Komuna e Mamushës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës dhe e Personelit ka pranuar gjithsej 172 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha.

2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar 25 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat.

3 Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka pranuar gjithsej 183 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha.

4 Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ka pranuar gjithsej 347 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat.

5 Drejtoria e Sherbimeve Publike ka pranuar 21 kërkesa, të gjitha këto kërkesa janë shqyrtuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Mamushës

Komuna e Mamushës gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa për mbledhje nga kjo komunë dërgohet kryesisht me kohë. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për qytetarët. Numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë këtij viti gjithsej është 10 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Numri i akteve të miratuara në këtë komunë është 18 vendime dhe 3 rregullore. Lidhur me efikasitetin e organeve të administratës së komunës, Komuna e Mamushës këto të dhëna nuk i ka ofruar përmes softuerit elektronik.

Kryetari i Komunës së Mamushës ka mbajtur 4 takime publike me qytetarët e kësaj komune. Ndërsa sa i përket çështjes së raportimit të kryetarit, Kryetari i Komunës së Mamushës nuk ka përmbushur obligimin ligjor në lidhje më raportimin, ku Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (neni 58 pika j) parasheh që kryetari i komunës duhet të raportoj para anëtareve të kuvendit se paku një here gjashtë muaj.

Komuna e Mamushës gjatë vitit 2011 është binjakëzua më disa komuna nga Republika e Turqisë dhe Republika e Shqipërisë.

Po ashtu duke pasur parasysh që në këtë komunë nuk ka plan urbanistik, është lidhur marrëveshja e mirëkuptimit më UN- HABITAT-in, ku ky projekt do të përkrahet më ndihmën teknike edhe nga Republika e Turqisë.

20.1

REKOMANDIME

- Komuna e Mamushës të fuksionalizoj softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunën e Mamushës të dërgohet ftesa dhe i materiali për mbledhje me kohë ashtu siç e parasheh LVL.

KOMUNA E DRAGASHIT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Dragashit ka një sipërfaqe prej 435 km² dhe përbëhet prej 36 fshatrash. Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 40.000 banorë. Në Komunën e Dragashit numri i anëtarëve të kuvendit është 27, të cilët zgjedhën drejtpërdrejt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 8, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 117.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka qenë funksional dhe i ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, që do të thotë se kjo komunë i ka përmbushur obligimet ligjore sa i përket mbajtjes së mbledhjeve.

Këto mbledhje kanë qenë transparente dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, KDI-së dhe qytetarët e interesuar. Ftesat për mbledhje kryesisht dërgohen me kohë, por nuk duhet përjashtuar edhe rastet e vonesës së ftesës për mbledhjet e kuvendit të kësaj komune.

Po ashtu, në këtë komunë janë funksionale edhe komitete obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 8 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak të 2010, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kishin mbajtur nga 5 mbledhje.

Sa i përket akteve komunale të miratuara në Kuvend, Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë vitit 2011 ka miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka shqyrtuar dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit për Biodiversitetin e Komunës së Dragashit 2011-2015.

Në Komunën e Dragashit është mbajtur edhe mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të UNDP për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë.

Në Komunën e Dragashit, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional dhe gjatë këtij viti i ka mbajtur vetëm 1 mbledhje. Ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Dragashit e ka të miratuar propozim buxhetin e komunës për vitin 2012, duke

60

respektuar instruksionet e qarkores buxhetore të MF-së.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Dragashit në periudhën e vitit 2010 ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ky Kuvend ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Nga kjo shihet se numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2011 është më i madh.

Tek komitetet obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 8 mbledhje. Krahasuar me vitin paraprak të 2010, këto komitete kishin mbajtur nga 5 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, gjatë vitit 2010 Kuvendi i Komunës së Dragashit kishte miratuar 19 vendime dhe 1 rregullore, ndërsa në vitin 2011, ku Kuvend ka miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore. Nga kjo rezulton se Kuvendi i Komunës së Dragashit në vitin 2011 ka shënuar numër më të ulët në miratimin e akteve komunale.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Dragashit

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat vetëm për drejtorit e kësaj komune. Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Dragashit për periudhën janar- dhjetor të vitit 2011 është 4015, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 3713 ose marrë në përqindje rezulton në 92.47%.

Duke krahasuar me periudhën janar- dhjetor të vitit 2010 numri i kërkesave të pranuar ishte 6421, ndërsa të shqyrtuara ishin 6400 ose marrë në përqindje 99.67%. Në periudhën janar- dhjetor të vitit 2011 numri i kërkesave të pranuar është 4015, ndërsa të shqyrtuara janë 3713 kërkesa ose marrë në përqindje 92.47%. Në krahasimin e këtyre të dhënave konstatojmë se në këtë vit numri i kërkesave të qytetarëve ka qene më i madh.

21.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

- Kuvendi i Komunës së Dragashit nuk ka respektuar kuotën e përfaqësimit gjinor me rastin e themelimit të Grupit Punues – REC me rastin e hartimit të Draft Planit të Veprimit të Komunës së Dragashit për Biodiversitet. Këtë vendim, Komuna nuk ka kthyer për rishqyrtim sipas rekomandimeve të Ministrisë.

Komuna e Dragashit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtorja e Administratës ka pranuar 792 kërkesa, të shqyrtuara janë 684 ndërsa te pasqyrtuara janë 108 kërkesa.

2 Drejtorja për Ekonomi dhe Financa ka pranuar 250 kërkesa , të shqyrtuara janë 134 ndërsa te pasqyrtuara janë 116 kërkesa.

3 Drejtorja për Mbrojtje, Shpëtim, Shërbime Publike dhe Siguri ka pranuar gjithsej 15 kërkesa, 9 prej tyre janë shqyrtuar ndërsa 6 nuk janë shqyrtuar ende.

4 Drejtorja e Arsimit nuk ka pranuar asnjë kërkesë gjate vitit 2011.

5 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar gjithsej 31 kërkesa, 29 prej tyre jan shqyrtuar ndërsa 2 nuk janë shqyrtuar ende.

6 Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim dhe Inspekcione ka pranuar gjithsej 965 kërkesa, 958 prej tyre janë shqyrtuare ndërsa 7 nuk janë shqyrtuare ende.

7 Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit ka pranuar gjithsej 109 kërkesa, të shqyrtuara janë 46 ndërsa te pasqyrtuara janë 63.

8 Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport nuk ka pranuar asnjë kërkesë.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Dragashit

Komuna e Dragashit gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 në përgjithësi ka qenë funksionale. Gjatë kësaj periudhe kjo komunë ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Kjo komunë ftesat dhe materialet për mbledhje i dërgon kryesisht me vonesë. Sa i përket numrit të akteve të miratuara, në këtë komunë janë miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore. Lidhur me efikasitetin e organeve të administratës së komunës, Komuna e Dragashit këto të dhëna i ka ofruar përmes softuerit elektronik. Kryetari i Komunës së Dragashit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 2 takime publike me qytetarët e kësaj komune. Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë para anëtarëve të kuvendit ashtu siç e parash Ligji për Vetëqeverisjen Lokale.

21.2

REKOMANDIME

- Komuna e Dragashit të dërgojë me kohë aktet e miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL ashtu siç e parasheh LVL-ja;
- Komuna e Dragashit të dërgoj me kohë ftesën dhe materialin për mbledhje të Kuvendit ashtu siç e parasheh LVL;

Në Komunën e Dragashit gjatë kësaj periudhe është mbajtur edhe mbledhja e Këshillit Drejtues të Projektit të UNDP për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë në këtë komunë. Poashtu gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kuvendi i Komunës së Dragashit e ka shqyrtuar dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit për Biodiversitetin e Komunës së Dragashit 2011-2015.

61

22

KOMUNA E MITROVICËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Mitrovicës ka 49 fshatra, me qendër në Mitrovicë me një sipërfaqe prej 350km². Popullsia në këtë Komunë është rreth 110.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është 12, ndërsa numri i stafit të administratës komunale është 200.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka mbajtur 13 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 6 mbledhje të Komitetit për Komunitete. Kuvendi i Komunës ka pesë 5 Komitete Konsultative, në përputhje me nenin 73.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe kanë mbajtur gjithsej 18 mbledhje, ndërsa komitete funksionale kanë mbajtur gjithsej 15 mbledhje. Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në mbledhjet e rregullta ka shqyrtuar gjithsej 83 pika të rendit të punës, me ç'rast ka miratuar 5 rregullore, në parim janë miratuar edhe dy rregullore, ka nxjerrë 49 vendime, 4 konkluzione, 2 deklarata politike, 1

komunikatë dhe 1 reagim, si dhe ka shqyrtuar 3 raporte dhe 11 informata.

Ndër vendimet më të rëndësishme që ka sjellë Kuvendi i Komunës në këtë periudhë është: Vendimi për zgjedhjen e Emblemës së Komunës, miratimi i Planit rregullues urban "Qendra" 2010-2025+, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës, si dhe formimi i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të luftës.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 10 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë, që është pranuar 1 peticion nga qytetarët e Komunës në lidhje me shpalljen e interesit të përgjithshëm.

Në përputhje me nenin 38.2 dhe 59.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2011, nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit.

Në Komunën e Mitrovicës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 33 mbledhje.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Komuna e Mitrovicës në vitin 2011 ka mbajtur numër më të madh të mbledhjeve të Kuvendit, pra me gjithsejtë 13 mbledhje të mbajtura. KPF gjatë vitit 2011 ka mbajtur 13 mbledhje deri sa në vitin 2010 ka mbajtur 10 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2010 dhe 2011 ka mbajtur nga 6 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka qenë më aktiv gjatë vitit 2011. Në vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar 21 vendime dhe 1 rregullore, ndërsa në vitin 2011 ka miratuar numër më të madh të vendimeve me gjithsejtë 49 vendime dhe 5 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Mitrovicës

Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet e administratës të Komunës së Mitrovicës nga 01.01.2011, deri 30.12.2009 është 27218 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuara 25578 ose 94%. Ndërkohë që pjesa tjetër e kërkesave është ende në shqyrtim.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 7349 në vitin 2011 numri i kërkesave është 27305. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 54.31 %. Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 95,46% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 95,83%.

Komuna e Mitrovicës ka ofruar këto të dhëna:

1 Zyra e Kryetarit: ka pranuar gjithsej 511 kërkesa, të shqyrtuara 336, në shqyrtim 175 te refuzuara.

2 Drejtoria për Administratë dhe Personel: ka pranuar gjithsej 19.036 kërkesa, të shqyrtuara 18.792, në shqyrtim 229, te refuzuara 12, te pezulluara 3.

3 Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: ka pranuar gjithsej 599 kërkesa, kurse të shqyrtuara 440 kërkesa, të pa shqyrtuara ende janë 159 lëndë.

4 Drejtoria për Arsime: ka pranuar gjithsej 1507 kërkesa, të shqyrtuara 1446, në proces 61.

5 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte: ka pranuar gjithsej 139 kërkesa, të shqyrtuara 128, në shqyrtim 11.

6 Drejtoria për Planifikim Urban, planifikim: ka pranuar gjithsej 698 kërkesa, prej të cilave të miratuara kemi 302, kërkesa të pashqyrtuara ende janë 371 lëndë.

7 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim: ka pranuar gjithsej 67 kërkesa, 62 të shqyrtuara.

8 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale: ka pranuar gjithsej 370 kërkesa, të shqyrtuara 361.

9 Drejtoria për Bujqësi: ka pranuar 60 kërkesa dhe ka shqyrtuar të gjitha 60.

10 Drejtoria e Inspektoratit: ka pranuar gjithsej 1032 lëndë, të shqyrtuara 963, të pranuar në shqyrtim 59.

11 Drejtoria e Prokurimit: ka pranuar gjithsej 16 lëndë, të shqyrtuara 16.

12 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronësi: ka pranuar 2248 kërkesa dhe ka shqyrtuar 2061.

13 Drejtoria për Integrimet evropiane: ka pranuar gjithsej 377 lëndë, të shqyrtuara 249, të pranuar në shqyrtim 128.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Mitrovicës

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun.

Në mbledhje kryesisht kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, ICO-së, OJQ-ve, Mediet dhe qytetarët e interesuar etj.

LVL parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Mitrovicës gjatë vitit 2011 ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, në Komunën e Mitrovicës janë mbajtur 2 takime publike.

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Skenderajt, ka një sipërfaqe prej 378 km². Komuna e Skenderajt ka mbi 72.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 31 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 8, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 190.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e Kuvendit të Komunës kanë qenë funksionale për këtë periudhë kohore. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsejtë 10 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 9 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në vitin 2011 ka nxjerr 29 vendime dhe 7 rregullore.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Skenderajt për vitin 2011 nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, po ashtu as nga ana e Kryetarit.

Në Komunën e Skenderajt, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 ka mbajtur 10 mbledhje. Ky Këshill i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në vitin 2011 ka mbajtur numër më të vogël të mbledhjeve, pra me gjithsejtë 10 mbledhje të mbajtura. KPF gjatë vitit 2011 ka mbajtur 10 mbledhje derisa në vitin 2010 ka mbajtur 11 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2010 ka mbajtur 9 mbledhje, po aq ka mbajtur edhe gjatë vitit 2011.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka qenë më aktiv gjatë vitit

2011, me gjithsejtë 27 vendime dhe 5 rregullore të miratuara, kurse gjatë vitit 2010 ka miratuar 24 vendime dhe 3 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Skenderajt

Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet e administratës së Komunës së Skenderajt nga 01.01.2011 deri 30.12.2011 është 4700 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuara 4217 ose 89.07% . Ndërkohë numri i kërkesave në proces është 112.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 4280 në vitin 2011 numri i kërkesave është 4700 Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 97 % . Ndërsa nga kjo konstatohet se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 97% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 89.7%.

Komuna e Skenderajt ka ofruar këto të dhëna:

1 Zyra e Kryetarit: ka pranuar gjithsej 1090 kërkesa, ka miratuar 915, në proces 8, të refuzuara 43 dhe ka refuzuar 6

2 Drejtoria për Administratë dhe Personel: janë pranuar 685 kërkesa, prej tyre 660 të miratuara, te pashqyrtuara 6 dhe 12 të refuzuara.

3 Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: janë pranuar 492 kërkesa, prej të cilave 443 të miratuara, të refuzuara 42 dhe 1 në proces.

4 Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mjedis: janë pranuar gjithsej 413 kërkesa, prej tyre ka miratuar 407, te refuzuara 3 dhe 1 në proces.

5 Drejtoria për Arsim: të pranuar gjithsej 29, të miratuara 8, te refuzuara 18 dhe 3 proces.

6 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte: janë pranuar gjithsej 64 kërkesa, të miratuara 58 të refuzuara 4 dhe 1 në proces.

7 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar gjithsej 1163 kërkesa, prej tyre 1058 të miratuara, të refuzuara 61, të pashqyrtuara 44.

8 Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari: ka pasur gjithsej 51 kërkesa, të miratuara janë 40, të pezulluar 7 dhe 1 në proces.

9 Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike dhe Inspektoratit: janë pranuar gjithsej 347 kërkesa, prej tyre 316 të miratuara, të refuzuara 29.

10 Drejtoria e Kadastrës dhe Pronës: janë pranuar gjithsej 265 kërkesa, prej tyre 223 të miratuara, të pashqyrtuara 41 dhe 1 të refuzuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Skenderajt

Kuvendi i Komunës së Skenderajt, gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kryesisht kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, ICO-së, OJQ-ve, Mediet dhe qytetarët e interesuar etj.

LVL parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Skenderajt gjatë vitit 2011 ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Skenderajt ka mbajtur 2 takime publike.

KOMUNA E VUSHTRRISË

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Vushtrrisë, shtrihet në një sipërfaqe prej 344 km² me popullsi prej rreth 103.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është 9, ndërsa numri i stafit të administratës komunale është 170.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 6 mbledhje të Komitetit për Komunitete. Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 3 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Gjatë këtij viti nuk ka pasur raste të paraqitjes së konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës apo nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë ka raportuar 2 herë për punën e tij para Kuvendit të Komunës. Vlen të theksohet se kryetari i Komunës ka qenë i pranishëm gjatë gjithë punimeve të Kuvendit. Sa i përket miratimit të akteve komunale, gjatë vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka miratuar 87 vendime dhe 5 rregullore. Në Komunën e Vushtrrisë, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në vitin 2011 ka mbajtur 9 mbledhje. Ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në vitin 2011 ka mbajtur numër më të vogël të mbledhjeve, pra me gjithsejtë 10 mbledhje të mbajtura. KPF gjatë vitit 2011 ka mbajtur 10 mbledhje derisa në vitin 2010 ka mbajtur 13 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2010 ka mbajtur 9 mbledhje, po aq sa ka mbajtur edhe gjatë vitit 2011.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka qenë më aktiv gjatë vitit

2011, ngase ka miratuar 85 vendime dhe 5 rregullore, kurse gjatë vitit 2010 ka miratuar 66 vendime dhe 3 rregullore.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Vushtrrisë

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 8397 kërkesa, ndërsa të shqyrtuara janë 7512 ose 89.49%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 8559 në vitin 2011 numri i kërkesave është 8397 Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 97.2%. Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 97% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 89.49%.

Komuna e Vushtrrisë ka ofruar këto të dhëna:

1 Zyra e Kryetarit: ka pranuar gjithsej 1 kërkesa, të shqyrtuara 369, të shqyrtuara 256 te pranuar 110.

2 Drejtoria për Administratë dhe Personel: janë pranuar 1054 kërkesa, të shqyrtuara 1014, të refuzuara 10, të hedhura poshtë 10, të pezulluara 11.

3 Drejtoria për Buxhet dhe Financa: janë pranuar 168 kërkesa, prej të cilave 132 të shqyrtuara dhe 36 në proces.

4 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër: ka gjithsej 4360, kërkesa, të miratuara 4309, të refuzuara 31, të hedhura poshtë dhe të pranuar 18.

5 Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar gjithsej 513 kërkesa, prej tyre 405 janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 138.

6 Drejtoria për Arsim: janë pranuar gjithsej 82 kërkesa, prej tyre të

shqyrtuar 23, të pranuar 59.

7 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar gjithsej 185 kërkesa, prej tyre 29 të miratuara, të pranuar në proces 139.

8 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: ka pasur gjithsej 14 kërkesa, prej të cilave vetëm një është miratuara dhe 12 të pranuar ende pa u shqyrtuara.

9 Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural: ka pasur gjithsej 859 kërkesa të miratuara 858 dhe vetëm një të pezulluar.

10 Drejtoria për Emergjencë: gjithsej ka 12 kërkesa, të miratuar 8, të refuzuara 3 të pranuar 1.

10 Drejtoria e Prokurimit: ka 10 kërkesë gjithsej të pranuar 9 në proces 1.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Vushtrrisë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht dhe ka pasur një rritje të theksuar të nxjerrjes së akteve nënligjore. Ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kryesisht kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, ICO-së, OJQ-ve, Mediet dhe qytetarët e interesuar etj. LVL parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë gjatë vitit 2011 ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës. Sa i përket takimeve publike me qytetarë, në Komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 2 takime publike.

KOMUNA E GLOGOCIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Glogocit ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 6 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur një kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Në Komunë ka pasur raste të paraqitjes së konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, gjatë vitit 2011, Komuna e Glogocit ka miratuar 36 vendime dhe 4 rregullore.

Në Komunën e Glogocit, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 6 mbledhje gjatë vitit 2011. KKSBB nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSBB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Glogocit në vitin 2011 ka mbajtur numër më të vogël të mbledhjeve, pra me gjithsejtë 10 mbledhje të mbajtura. KPF gjatë vitit 2011 ka mbajtur 10 mbledhje derisa në vitin 2010 ka mbajtur 11 mbledhje. Përderisa Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2010 nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, gjatë vitit 2011 ka mbajtur 6 mbledhje. Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Glogocit ka qenë më aktiv gjatë vitit 2011, pasi që ka nxjerr 36 vendime dhe 4 rregullore, ndërsa gjatë vitit 2010 ka miratuar 20 vendime dhe 2 rregullore.

Informacion i përgjithshëm

Kjo komunë përbëhet prej 42 vendbanimesh, me një sipërfaqe prej 290 km² dhe popullsi prej mbi 73.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është 10. Numri i stafit të administratës komunale është 120.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Gllgocit

Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet e administratës të Komunës së Gllgocit nga 01.01.2011, deri 30.12.2011 është 18611 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuara 16735 ose 89.09%. Ndërkohë që pjesa tjetër e kërkesave është ende në shqyrtim.

Nga kjo vërehet se krahasuar me vitin 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 6138 në vitin 2011 numri i kërkesave është 18611. Kurse, sa iu përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 78.66. Ndërsa nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 97% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është 89.09%.

Komuna e Gllgocit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Zyra e Kryetarit: ka pranuar gjithsej 484, të miratuara 373 të, refuzuar 63, të hedhura poshtë 19 të pezulluara dy, kurse 27 në proces.

2 Drejtorja për Administratë dhe Personel: janë pranuar 5139 kërkesa, prej tyre 5071 të miratuara, të refuzuara 27, të hedhura poshtë 3 dhe 29 në proces.

3 Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: janë pranuar gjithsej 64 kërkesa prej të cilave 49 të miratuara, të hedhura poshtë 8.

4 Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Zhvillim: janë pranuar gjithsej 813 kërkesa. Prej tyre 675 janë të shqyrtuara, në proces 138.

5 Drejtorja për Arsim dhe Shkencë: janë pranuar gjithsej 2566 kërkesa, prej të miratuara 877, të refuzuara, 725 të pezulluara 12.

6 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar gjithsej 1370 kërkesa, prej tyre 1223 të shqyrtuara, të refuzuara 146, të pashqyrtuara 146.

7 Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: ka pasur gjithsej 281 kërkesa, të miratuara 166 pashqyrtuara 112 procedurë.

8 Drejtorja për Shërbime Publike dhe Siguri: janë pranuar gjithsej 398, kërkesa, prej tyre 317 të shqyrtuara, të refuzuara 24, të pashqyrtuara 54.

9 Drejtorja e Kadastrës dhe Pronës: janë pranuar gjithsej 6395 kërkesa, prej tyre 6386 të miratuara, të refuzuara 6, të pashqyrtuara 3.

10 Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport: janë pranuar gjithsej 70 kërkesa, prej tyre 52 të miratuara, të refuzuara 12, të pashqyrtuara 6.

11 Drejtorja për Inspektim: janë pranuar gjithsej 976 kërkesa, prej tyre 592 të miratuara, të refuzuara 3, të hedhura poshtë 8, të pezulluara 8, në proces 347.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Gllgocit

Kuvendi i Komunës së Gllgocit, gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kryesisht kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, ICO-së, OJQ-ve, Mediet dhe qytetarët e interesuar etj.

LVL parasheh që Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Gllgocit gjatë vitit 2011 ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës. Sa i përket takimeve publike me qytetarë, në Komunën e Gllgocit janë mbajtur 2 takime publike.

KOMUNA E ISTOGUT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në mbledhje kryesisht kanë qenë prezent edhe përfaqësues të: KFOR-it, OSBE-së, OJQ-ve, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Në vitin 2011, ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje solemne, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Që do të thotë se numri mbledhjeve të rregullta ka qenë i njëjtë më atë të vitit paraprak.

Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Istogut kanë qenë funksionale Komitetet obligative. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje. Këto komitete gjatë vitit 2011 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak të 2010 ku KPF kishte mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK-10 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar akte komunale me rëndësi dhe me interes për qytetarët. Nga aspekti kuantitativ, Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar 5 rregullore dhe 26 vendime, ky numër i akteve të miratuara është pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2010. Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Istogut gjatë vitit 2011 ka ngritur Komitetin për Auditim.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare.

Po ashtu, në këtë Komunë është funksional edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur 9 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Istogut ka një sipërfaqe prej 454 km². Kjo komunë ka një popullsi prej rreth 56.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 27 anëtarë. Numri i drejtorive është tetë (8), numri i stafit të administratës komunale është 158.

kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MF-së. Po ashtu, gjatë vitit 2011 është miratuar edhe Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012, Plani i punës së KKSBB-ve, si dhe Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Istogut në periudhën e vitit 2010 ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve me vitin 2011.

Tek komitetet obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje. Këto komitete gjatë vitit 2011 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak të 2010 ku KPF kishte mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK-10 mbledhje.

Sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar 5 rregullore dhe 26 vendime, ky numër i akteve të miratuara është pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2010.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën Istogut

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhënat vetëm për drejtorit e kësaj Komune. Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të Administratës të Komunës së Istogut në vitin 2011 është 3.343, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 2.834 ose marrë në përqindje rezulton 84.7%. Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 numri i kërkesave të paraqitura është rritur për 63 kërkesa. Në vitin 2010 ishin paraqitur gjithsej 3.280 kërkesa.

Ndërsa sa i përket raportit të kërkesave të pranuar dhe të shqyrtuara në vitin 2011 ka pasur rënie të përqindjes në krahasim me vitin 2010.

Në vitin 2010 nga 3.280 kërkesa të pranuar ishin shqyrtuar 3128 ose marrë në përqindje 95.36%, ndërsa në vitin 2011 nga 3.343 kërkesa të paraqitur janë shqyrtuar 2.834 ose

marrë në përqindje 84.7%.

Komuna e Istogut ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës dhe Personelit – janë pranuar gjithsej 486 kërkesa, prej të cilave 441 janë shqyrtuar ndërsa 45 janë në proces të shqyrtimit.

2 Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet – janë pranuar gjithsej 203 kërkesa, të shqyrtuar 177, ndërsa në proces 26.

3 Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër – janë pranuar gjithsej 1.594 kërkesa, prej të cilave 1.464 janë shqyrtuar, ndërsa 130 janë në proces të shqyrtimit.

4 Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport – janë pranuar gjithsej 50 kërkesa, prej tyre 34 janë shqyrtuar ndërsa 16 janë në proces të shqyrtimit.

5 Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Siguri – janë pranuar gjithsej 419 kërkesa, prej tyre 381 janë shqyrtuar, ndërsa 38 janë në proces të shqyrtimit.

6 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – janë pranuar gjithsej 57 kërkesa, të shqyrtuara 43, ndërsa në proces 56. Drejtoria e Inspektoratit – janë pranuar gjithsej 118 kërkesa, të miratuara 62, ndërsa në proces të shqyrtimit 11. Drejtoria për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural – janë pranuar gjithsej 416 kërkesa, prej tyre 232 janë shqyrtuar ndërsa 184 janë në proces të shqyrtimit.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Istogut

Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje solemne ndërsa mbledhje të

72

jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Në këtë Komunë gjatë vitit 2011 kanë qenë janë funksionale edhe Komitete obligative të Kuvendit. Në vitin 2011 Komuna e Istogut ka ngritur edhe Komitetin për Auditim.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendimmarrjes, komunat kanë organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë kontekst, Komuna e Istogut në vitin 2011 ka mbajtur 2 takime publike me qytetarët.

Po ashtu në këtë Komunë është funksional edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur 9 mbledhje.

Kuvendi i Komunës ka miratuar Vendime dhe Rregullore me rëndësi dhe me interes për qytetarët, nga aspekti kuantitativ Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar 5 Rregullore dhe 26 Vendime.

Konform Statutit të Komunës dhe LVL-së, Kryetari i Komunës së Istogut ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës.

26.1

REKOMANDIME

- Në Komunën e Istogut, KKSBB të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.

Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Në kuadër të aktivitetit të tij, Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë vitit 2011 ka miratuar Planin Rregullues Urban për Gurakocin, Planin Rregullues Urban për Banjë, Planin Zhvillimor Urban për Saradran dhe Planin Rregullativ për Vrellës.

27

KOMUNA E KLINËS

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Klinës përbëhet prej 54 vendbanimesh me qendër qytetin e Klinës, me një sipërfaqe prej 309 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 60.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 27 anëtarë. Numri i drejtorive është dhjetë(10), ndërsa numri i stafit të administratës komunale është 126.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Komuna e Klinës gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 4 mbledhje solemne, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Nga kjo mund të shihet se Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur numrin e mbledhjeve në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në Kuvendin e Komunës së Klinës, në vitin 2011 është bërë plotësimi i pozitës së mbetur të anëtares së Kuvendit për shkak se anëtarja e Kuvendit ka ndërruar jetë.

Edhe trupat e Kuvendit të Komunës kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohore. Në këtë drejtim

janë realizuar 12 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Kuvendi i Komunës së Klinës në vitin 2011 ka miratuar akte komunale me rëndësi dhe me interes për qytetarët. Në këtë drejtim janë miratuar gjithsej 58 vendime dhe 2 rregullore. Duhet cekur se në vitin 2011 janë marrë vendime për ndryshimin dhe plotësimin e dy Rregulloreve në këtë Komunë: Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës dhe Rregullores për ngarkesa tarifa dhe taksa komunale. Kur jemi tek aktet komunale, vlen të ceket se gjatë vitit 2011 komuna e Klinës ka miratuar Vendimin për binjakëzimin e Komunës së Klinës me Komunën e Adapazarit të Turqisë.

Po ashtu në këtë Komunë është funksional Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur 8 mbledhje.

Kuvendi i Komunës në periudhën e raportimit ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projektionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Krahasimi me vitin paraprak

Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 4 mbledhje solemne, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, kjo komunë ka mbajtur numrin e njëjtë të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit.

Numri i mbledhjeve të Komiteteve obligative ka shënuar rritje gjatë vitit 2011. Në vitin 2010 KPF kishte mbajtur 8 mbledhje, ndërsa KK-kishte mbajtur 9 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 KPF ka mbajtur 12 mbledhje kurse KK ka mbajtur 11 mbledhje.

Po ashtu, për dallim nga viti 2010, Kuvendi i Komunës së Klinës në vitin 2011 është treguar më aktiv për nga miratimi i akteve komunale. Në vitin 2010 ky Kuvend kishte

miratuar gjithsej 40 Vendime, ndërsa në vitin 2011 janë miratuar 58 Vendime dhe 2 Rregullore.

Numri i takimeve publike me qytetarët është i njëjtë si në vitin 2010, që do të thotë se edhe në vitin 2010 janë mbajtur 3 takime me publikun.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Klinës

Në pasqyrën e mëposhtëm janë përfshirë të dhëna vetëm për drejtorit e kësaj Komune. Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të Administratës të Komunës së Klinës gjatë vitit 2011 është 4.254 , ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 3.790 ose marrë në përqindje rezulton 89%. Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 numri i kërkesave të paraqitura është rritur për 1632 kërkesa. Në vitin 2010 ishin pranuar 2622 kërkesa, prej të cilave ishin shqyrtuar 2.094.

Edhe sa i përket kërkesave të shqyrtuara gjatë këtij viti ka pasur rritje, pasi që në vitin 2010 janë shqyrtuar 79.86%, e tyre, ndërsa në vitin 2011 janë shqyrtuar 89%.

Komuna e Klinës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria për Administratë dhe Personel – janë pranuar gjithsej 1.144 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

2 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë – janë pranuar gjithsej 569 kërkesa, të shqyrtuara 557 , ndërsa në proces të shqyrtimit janë 12.

3 Drejtoria e Arsimit – janë pranuar gjithsej 40 kërkesa, të shqyrtuara 27, ndërsa në proces të shqyrtimit 11.

4 Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – janë pranuar 775 kërkesa, të shqyrtuara 758, ndërsa në proces të shqyrtimit janë 17.

74

5 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – janë pranuar 339 kërkesa, të shqyrtuara 758, në proces të shqyrtimit 239.

6 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – janë pranuar 144 kërkesa, të shqyrtuara 131, në proces të shqyrtimit 13.

7 Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – janë pranuar 742 kërkesa, të shqyrtuara 666, në proces të shqyrtimit 76.

8 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – janë pranuar 14 kërkesa, të shqyrtuara 13, në proces të shqyrtimit 1.

9 Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi – janë pranuar 163 kërkesa, të shqyrtuara 76, në proces të shqyrtimit 87.

10 Drejtoria për Inspektorat - janë pranuar 324 kërkesa, të shqyrtuar 316, në proces të shqyrtimit 8.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Klinës

Kuvendi i Komunës së Klinës gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta dhe 4 mbledhje solemne ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Edhe trupat e Kuvendit të Komunës, kanë funksionuar normalisht për këtë periudhë kohor.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendimmarrjes, komunat kanë organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë kontekst, Komuna e Klinës në vitin 2011

ka mbajtur 3 takime publike me qytetarët. Po ashtu në këtë Komunë është funksional edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur 8 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Klinës në vitin 2011 ka miratuar Vendime dhe Rregullore me rëndësi dhe me interes për qytetarë, janë miratuar gjithsej 58 Vendime dhe 2 Rregullore. Kur jemi tek aktet komunale, vlen të ceket se gjatë vitit 2011 komuna e Klinës ka miratuar Vendimin për binjakëzimin e Komunës së Klinës me Komunën e Adapazarit të Turqisë.

Në vitin 2011, për shkak që anëtarja e Kuvendit të Komunës ka ndërruar jetë është bërë plotësimi i pozitës së mbetur.

Sipas të dhënave në dispozicion Kryetari i Komunës së Klinës gjatë vitit 2011 ka raportuar 1 herë para Kuvendit të Komunës, gjë e cila nuk është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës në periudhën e raportimit ka miratuar propozim buxhetor për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

27.1

REKOMANDIME

- Në Komunën e Klinës, KKSB të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL;
- Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;

KOMUNA E MALISHEVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km².

Komuna e Malishevës ka mbi 65,000 banorë.

Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 31 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët.

Kuvendi i Komunës, numëron gjithsej 11 drejtori. Ndërsa numri i stafit të administratës së Komunës është 146.

Komuna e Malishevës gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 ka funksionuar normalisht, ftesa dhe materiali për mbledhje është dërguar konform nenit 43.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, 5 mbledhje solemne, dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme.

Edhe trupat e Kuvendit të Komunës, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore janë realizuar 10 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 1 mbledhje të Komitetit për Komunitete, nga kjo mund të konstatohet se ky Komitete nuk ka qenë aktiv gjatë vitit 2011 sa i përket mbajtjes së mbledhjeve.

Kuvendi i Komunës së Malishevës në vitin 2011 ka miratuar akte komunale me rëndësi dhe me interes për qytetarët. Në këtë drejtim janë miratuar gjithsej 25 vendime dhe 1 rregullore.

Në këtë Komunë gjatë vitit 2011 është miratuar Rregullorja për tarifa,, ngarkesa dhe gjoba i është nënshtrua 2 herë ndryshimeve.

Kur jemi tek aktet Komunale, vlen të potencohet fakti se, Komuna e Malishevës edhe gjatë vitit 2011 nuk e ka miratuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve, gjë që bie në kundërshtim me nenin 9.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Edhe në këtë Komunë me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, është bërë zëvendësimi i një anëtare të Kuvendit, për shkak të zgjedhjes së saj Deputete në Parlamentin e Kosovës.

Në Komunën e Malishevës është funksional edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Ky këshillë gjatë vitit 2011 ka mbajtur 7 mbledhje.

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren

buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Po ashtu sipas të dhënave që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare.

Krahasimi me vitin paraprak

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, kjo komunë këtë vit ka shënuar rritje të numrit të mbledhjeve të Kuvendit. Vitin e kaluar ishin mbajtur 10 mbledhje të rregullta të Kuvendit dhe 1 e jashtëzakonshme, kurse këtë vit janë mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Po ashtu edhe numri i mbledhjeve të Komiteteve obligative ka shënuar rritje gjatë vitit 2011.

Në vitin 2010, KPF në këtë komunë kishte mbajtur 6 mbledhje, ndërsa KK- nuk kishte mbajtur asnjë mbledhje. Ndërsa në vitin 2011, KPF ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 1 mbledhje.

Për dallim nga viti 2010, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vitin 2011 është treguar më aktiv për nga miratimi i akteve komunale. Në vitin 2010 ky Kuvend kishte miratuar gjithsej 17 vendime dhe 6 rregullore, ndërsa në vitin 2011 janë miratuar 25 vendime dhe 1 rregullore.

Ndërsa numri i takimeve publike me qytetarët është i njëjtë si në vitin 2010, që do të thotë se edhe në vitin 2010 janë mbajtur 2 takime me publikun.

28.1

EVIDENTIMI I SHKELJEVE LIGJORE

- Komuna e Malishevës edhe gjatë vitit 2011 nuk e ka miratuar Rregulloren për Përdorim të Gjuhëve.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Malishevës

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhëna vetëm për drejtoritë e kësaj Komune. Të dhënat për këtë Komunë nuk janë ofruar nga softueri.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të Administratës të Komunës së Malishevës në vitin 2011 është 3.754 kërkesa, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 3.479 ose marrë në përqindje rezulton 92.67%.

Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 numri i kërkesave të paraqitura është zvogëluar për 296 kërkesa. Në vitin 2010 ishin pranuar gjithsej 4.050 kërkesa.

Po ashtu edhe sa i përket raportit të kërkesave të pranuar dhe të shqyrtuara në vitin 2011 ka rënie të përqindjes në krahasim me vitin 2010.

Në vitin 2010 nga 4.050 kërkesa të pranuar ishin shqyrtuar 3.948 ose marrë në përqindje 99.24%, ndërsa në vitin 2011 nga 3.754 kërkesa të paraqitur janë shqyrtuar 3479 ose marrë në përqindje 92.67%.

Komuna e Malishevës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme – janë pranuar gjithsej 1945 dhe të gjitha janë shqyrtuar.

2 Drejtoria për Arsim dhe Edukim – janë pranuar gjithsej 22 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

3 Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari – janë pranuar gjithsej 39 kërkesa, dhe të gjitha janë shqyrtuar.

4 Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet – janë pranuar gjithsej 180 kërkesa, dhe të gjitha janë shqyrtuar.

5 Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri – janë pranuar gjithsej 53 kërkesa, prej tyre 47 janë shqyrtuar, ndërsa 6 janë në proces.

6 Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – janë pranuar gjithsej 659 kërkesa, dhe të gjitha janë shqyrtuar.

7 Drejtoria për Inspektorat – janë pranuar gjithsej 132 kërkesa, që të gjitha janë shqyrtuar.

8 Drejtoria për Kulturë – janë pranuar gjithsej 22 kërkesa, dhe që të gjitha janë shqyrtuar.

9 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – janë pranuar gjithsej 243 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

10 Drejtoria për Shërbime Publike – janë pranuar gjithsej 379 kërkesa, të gjitha të miratuara.

11 Drejtoria për Urbanizëm – janë pranuar gjithsej 80 kërkesa, prej tyre 54 janë shqyrtuar, ndërsa 26 janë në proces të shqyrtimit.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Malishevës

Edhe Kuvendi i Komunës së Malishevës gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ky kuvend ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, 5 mbledhje solemne dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Sa i përket Komiteteve obligative në këtë Komunë vlen të ceket se, gjatë vitit 2011 KPF ka mbajtur 10 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur një mbledhje nga kjo mund të konstatohet se ky Komitete nuk ka qenë aktiv gjatë vitit 2011 sa i përket mbajtjes së mbledhjeve.

Kuvendi i Komunës së Malishevës në vitin 2011 ka miratuar Vendime dhe Rregullore me rëndësi dhe me interes për qytetarë, janë miratuar gjithsej 25 Vendime dhe 1 Rregullore.

Në këtë Komunë gjatë vitit 2011, Rregullorja për tarifa,, ngarkesa dhe gjoba i është nënshtrua 2 herë ndryshimeve.

Kur jemi tek aktet Komunale, vlen të potencohet fakti se, Komuna e Malishevës edhe gjatë vitit 2011 nuk e ka miratuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve, gjë që bie në kundërshtim me nenin 9.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Edhe në këtë Komunë me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, është bërë zëvendësimi i një anëtare të Kuvendit, për shkak të zgjedhjes së saj Deputete në Parlamentin e Kosovës.

Sipas të dhënave në dispozicion Kryetari i Komunës së Malishevës gjatë vitit 2011 ka raportuar 2 herë para Kuvendit të Komunës.

Në Komunën e Malishevës është funksional edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Ky këshillë gjatë vitit 2011 ka mbajtur 7 mbledhje.

28.2

REKOMANDIME

- Në Komunën e Malishevës KKS-të të jenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.
- Komuna e Malishevës të miratoj Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve;
- Komuna e Malishevës të funksionalizoj softuerin e CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2011.
- Komiteti për Komunitete në Komunën e Malishevës të jetë më aktiv sa i përket mbajtjes së mbledhjeve.

KOMUNA E PEJËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, Kuvendi i Komunës së Pejës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e Kuvendit të Komunës, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje.

Sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë vitit 2011, ka miratuar 2 rregullore dhe 59 vendime.

Ajo që vlen të potencohet te kjo Komunë është fakti se, në vazhdimësi në mbledhjet e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2011 kanë qenë evidente rastet e këmbimit të pronave private me ato komunale, rastet e dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore që janë nën menaxhimin e AKP-së, duke bërë kështu shkelje ligjore.

Në Komunën e Pejës gjatë vitit 2011, ka pasur lëvizje të anëtarëve të Kuvendit, me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, tre anëtarë të Kuvendit të Komunës së Pejës kanë dhënë dorëheqje dhe është bërë zëvendësimi i tyre.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional në Komunën e Pejës, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Pejës, gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Në këtë periudhë të raportimit, Komuna ka mirat-

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Pejës është me një sipërfaqe prej rreth 603km².

Komuna e Pejës, ka mbi 170.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 41 anëtarëve, të cilët zgjedhën direkt nga qytetarët.

Komuna e Pejës ka gjithsej 14 drejtori, ndërsa numri i stafit të administratës së Komunës është 296.

uar Plani Lokal i Administrimit të mbeturinave në Komunën e Pejës.

Po ashtu në vazhden e aktivitetiteve të tij, Kuvendi i Komunës së Pejës ka miratuar edhe Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Pejës për periudhën afatmesme 2011-2016.

Krahasimi me vitin paraprak

Komuna e Pejës edhe këtë vit ka mbajtur numrin e njëjtë të mbledhje të rregullta të Kuvendit, sikurse në vitin 2011.

Ndërsa numri i mbledhjeve të Komiteteve obligative ka shënuar rritje gjatë vitit 2011.

Në vitin 2010 KPF në këtë komunë kishte mbajtur 7 mbledhje, ndërsa KK-kishte mbajtur 9 mbledhje, kurse në vitin 2011 KPF ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 12 mbledhje.

Po ashtu për dallim nga viti 2010, Kuvendi i Komunës së Pejës në vitin 2011 është treguar më aktiv edhe për nga miratimi i vendimeve, pasi që në vitin 2010 ky Kuvend kishte miratuar gjithsej 40 vendime, ndërsa në vitin 2011 janë miratuar 59 vendime, ndërsa sa i përket miratimit të rregulloreve ka pasur rënie gjatë vitit 2011 ku të miratuara janë 2 rregullore, ndërsa në vitin 2010 ishin miratuar 10 rregullore.

Numri i takimeve publike me qytetarët është i njëjtë si në vitin 2010, që do të thotë se edhe në vitin 2011 kjo komunë kishte mbajtur 2 takime publike.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Pejës

Në pasqyrën e mëposhtme janë përfshirë të dhëna vetëm për drejtorit e kësaj Komune. Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura para organeve të Administratës të Komunës së Pejës në vitin 2011 është 7.512, ndërsa prej tyre të shqyrtuara janë 5.120 ose marrë në përqindje rezulton 68.15%.

Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 numri

29.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

79

- Kuvendi i Komunës së Pejës ka bërë shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimin ku të gjitha pronat e shoqërore në emër të ish-kooperativave bujqësore të cilat gjenden në territorin e Komunës së Pejës, të barten në emër të Kuvendit të Komunës së Pejës. Edhe pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimi, Komuna nuk ka përfillur kërkesën e Ministrisë.
- Kuvendi i Komunës së Pejës ka bërë shkelje ligjore me rastin e këmbimit të pronës së ish-“Kombinatit të drurit) në Pejë me pronë private. Megjithëse MAPL ka kërkuar rishqyrtimin e këtij vendimi, Komuna nuk ka kthyer në rishqyrtim sipas rekomandimeve të Ministrisë.

i kërkesave të paraqitura është rritur për 3.249 kërkesa. Në vitin 2010 ishin pranuar 4343 kërkesa,.

Ndërsa sa i përket raportit të kërkesave të pranuar dhe të shqyrtuara në vitin 2011 ka pasur rënie të përqindjes në krahasim me vitin 2010.

Në vitin 2010 nga 4343 kërkesa të pranuar ishin shqyrtuar 4245 ose marrë në përqindje 97.74%, ndërsa në vitin 2011 nga 7.512 kërkesa të paraqitura janë shqyrtuar 5.120 ose marrë në përqindje 68.15%.

Komuna e Pejës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtoria për Administratë dhe Personel – janë pranuar gjithsej 886 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 755, ndërsa në proces të shqyrtimit janë 131.

80

2 Drejtoria e Arsimit – janë pranuar gjithsej 19 kërkesa, të shqyrtuara 13, ndërsa në proces të shqyrtimit janë 6.

3 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – janë pranuar gjithsej 386 kërkesa, të shqyrtuara 376, ndërsa në proces janë 10.

4 Drejtoria për Investime të Jashtme – janë pranuar 10 kërkesa, të gjitha janë në proces.

5 Drejtoria për Shërbime Pronësoro-Juridike – janë pranuar gjithsej 172 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 76, ndërsa 96 janë në proces të shqyrtimit.

6 Drejtoria për Buxhet dhe Financa – janë pranuar gjithsej 1.065 kërkesa, prej tyre 768 janë shqyrtuar, ndërsa 297 janë në proces të shqyrtimit.

7 Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi – janë pranuar gjithsej 7 kërkesa, të gjitha në proces.

8 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – janë pranuar gjithsej 900 kërkesa, prej tyre 711 janë shqyrtuar, ndërsa 189 janë në proces.

9 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – janë pranuar gjithsej 1.093 kërkesa, prej tyre 554 janë shqyrtuar, ndërsa 539 janë në proces të shqyrtimit.

10 Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim – janë pranuar gjithsej 118 kërkesa, prej tyre 77 janë shqyrtuar, ndërsa 41 janë në proces.

11 Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport – janë pranuar gjithsej 134 kërkesa, prej tyre 34 janë shqyrtuar, ndërsa 100 janë në proces.

12 Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike – janë pranuar gjithsej 481 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar

479, ndërsa 2 janë në proces të shqyrtimit.

13 Drejtoria për Punë Inspektuese – janë pranuar gjithsej 1.393 kërkesa, prej tyre 579 janë shqyrtuar, ndërsa 814 janë në proces.

14 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi – janë pranuar gjithsej 850 kërkesa, të shqyrtuara 700, ndërsa në proces të shqyrtimit 150.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Pejës

Edhe Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Ky Kuvend ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta. Sa i përket Komiteteve obligative në këtë Komunë gjatë vitit 2011 KPF ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 12 mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Pejës në vitin 2011 ka miratuar Vendime dhe Rregullore me rëndësi dhe me interes për qytetarë, janë miratuar gjithsej 59 Vendime dhe 2 Rregullore. Ajo që vlen të potencohet te kjo Komunë është fakti se, në vazhdimësi në mbledhjet e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2011 kanë qenë evidente rastet e këmbimit të pronave private me ato komunale, rastet e dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore që janë nën menaxhimin e AKP-së, duke bërë kështu shkelje ligjore.

Edhe në Komunën e Pejës gjatë vitit 2011, ka pasur lëvizje të anëtarëve të Kuvendit, me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, tre anëtarë të Kuvendit të Komunës së Pejës kanë dhënë dorëheqje dhe është bërë zëvendësimi i tyre.

Kuvendi i Komunës së Pejës, gjatë vitit 2011 ka miratuar propozim buxhetin për vitin 2012 si dhe projeksionet buxhetore 2012-2014, ashtu siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Sipas të dhënave në dispozicion Kryetari i Komunës së Pejës gjatë vitit 2011 ka raportuar 1 herë para Kuvendit të Komunës, gjë e cila nuk është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë periudhë të raportimit, Komuna ka miratuar Plani Lokal i Administrimit të mbeturinave në Komunën e Pejës. Po ashtu në vazhden e aktivitetiteve të tij Kuvendi i Komunës së Pejës ka miratuar edhe Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Pejës për periudhën afatmesme 2011-2016. Edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është funksional në Komunën e Pejës, i cili gjatë vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje

29.2

REKOMANDIMET

- **Komuna e Pejës të siguroj integrimin e softuerit që përdor me ueb faqen e komunës, ashtu që të siguroj që ato të raportohen edhe nga serveri i Ministrisë.**
- **Kryetari i Komunës të raportoj para Kuvendit të Komunës konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.**

81

30

KOMUNA E HANIT TË ELEZIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011, në bazë të monitorimit të rregullt të kuvendit rezulton se kuvendi i komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve në këtë vit, ku gjithësejt janë mbajtur 12 mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk pasur.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt të mos merr pjesë në punën e Kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendeve të Komunave është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita.

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme. Në Komunën e Hanit të Elezit, KPF ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 5. Gjithashtu kanë qenë funksionale edhe komitetet konsultative.

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Hanit të Elezit përbëhet prej 12 fshatrave me qendër në Hanin e Elezit, me një sipërfaqe prej 83 km². Popullsia në këtë komunë sillet rreth 11.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është 9, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 55.

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar gjithsejtë 57 akte juridike. Prej tyre janë nxjerrë 52 vendime dhe 5 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, nga qytetarët e Komunës.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës.

Në Komunën e Hanit të Elezit, Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur 12 mbledhje.

Komuna e Hanit të Elezit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin Social-Ekonomik Lokal.

Krahasimi me vitin paraprak

Nëse e krahasojmë me vitin 2010, del se Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të rregullta me vitin 2011 me nga 12 mbledhje. Ndërsa, sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme në vitin 2010 ka qenë 1 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 nuk ka pasur mbledhje

të jashtëzakonshme.

Gjithashtu edhe Komitetet e obligueshme krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011 del se kanë mbajtur numër më të madh të mbledhjeve. KPF-ja në vitin 2010 ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje. KK-ja në vitin 2010 ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa në vitin 2011, ka mbajtur 5 mbledhje.

Kurse sa i përket akteve komunale, Komuna e Hanit të Elezit ka qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale në vitin 2011. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 52 vendime dhe 5 rregullore. Ndërsa, numri i këtyre akteve të miratuara në vitin 2010 ka qenë 27 vendime dhe 7 rregullore. Nga kjo vërehet së në vitin 2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit ka dërguar raportin për 9 drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 9043, prej të cilave 8999 ose 99.51% prej tyre janë shqyrtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

Nga kjo vërehet se në vitin 2011 kemi ngritje të efikasitetit në organet administrative të komunës së Hanit të Elezit në krahasim me vitin 2010 ku gjithsejtë kanë qenë 1337 kërkesa, të shqyrtuara kanë qenë 968 ose 72.40%. Nga kjo konstatohet se deri sa në vitin 2010 janë shqyrtuar 72.40%. të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është rritë në 91.32%.

Komuna e Hanit të Elezit ka ofruar këto të dhëna:

1 Zyra e Kryetarit: janë pranuar gjithësejt 532 kërkesa të shqyrtuara janë 530, të pashqyrtuara 2 kërkesa.

30.1

EVIDENTIMI I SHKELJEVE LIGJORE

- Komuna e Hanit të Elezit ka bërë shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike komunale. Komuna nuk ka bërë rishqyrtimin e këtij vendimi përkundër kërkesës së MAPL-së.

2 Drejtoria për Administratë të Përgjithshme: janë pranuar gjithsej 6078 kërkesa, të shqyrtuara 6077, të pashqyrtuara janë 1 kërkesë.

3 Drejtoria për Buxhet dhe Financa: janë pranuar gjithsej 360 kërkesa, të shqyrtuara 357, të pashqyrtuara 3 kërkesa.

4 Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar gjithsej 1353 kërkesa, të shqyrtuara 1350, të pashqyrtuara janë 3 kërkesa.

5 Drejtoria për Arsim , Kulturë dhe Sport : janë pranuar 281 kërkesa, të shqyrtuara janë 278, të pashqyrtuara 3 kërkesa.

6 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar gjithësejt 136 kërkesa, të shqyrtuara janë 122, të pashqyrtuara janë 14 kërkesa.

7 Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik : nuk ka pranuar asnjë kërkesë.

8 Drejtoria e Prokurimit: janë pranuar gjithësejt 56 kërkesa , janë shqyrtuar 46, të pashqyrtuara janë 10 kërkesa.

9 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë : janë pranuar gjithësejt 172 kërkesa , të shqyrtuara janë të gjitha.

10 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: janë pranuar gjithësejt 75 kërkesa, të shqyrtuara janë 67 kërkesa, të pashqyrtuara janë 8 kërkesa.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Hanit të Elezit

Gjatë vitit 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta . Këto Komuna, kanë vepruar brenda dinamikës së paraparë të mbajtjes së mbledhjeve,

ashtu siç parashihet me LVL.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktiviteteve të Komunave bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunave.

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihet që Kryetari i Komunës të raporton para Kuvendit së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në Komunën e Hanit të Elezit, Kryetari Komunës ka raportuar 2 herë.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendim marrjes, komuna ka organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, Komuna e Hanit të Elezit, ka mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë.

30.1

REKOMANDIME

- Të respektohet neni 68 i LVL-së në lidhje me mbajtjen e takimeve publike me qytetarë;
- Komuna e Hanit të Elezit të marrë parasysh të gjitha kërkesat për rishqyrtim të akteve komunale të cilat janë rrjedhojë e vlerësimeve të MAPL-së si dhe komisioneve ndërministrare.
- Komuna e Hanit të Elezit të respektojë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komuna e Hanit të Elezit të funksionalizojë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011.

KOMUNA E OBILIQIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, në bazë të monitorimit të rregullt të Kuvendit rezulton se Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve me gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga Komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt të mos merr pjesë në punën e Kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita.

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Obiliqit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme.

Në Komunën e Hanit të Elezit, KPF ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 4.

Gjithashtu janë funksionale edhe komitete konsultative. Në tërësi, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka shqyrtuar 62 pika të rendit të ditës dhe prej tyre ka miratuar gjithsejtë 56 akte juridike. Ky Kuvend ka miratuar 62 vendime dhe 4 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 41 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, nga qytetarët e Komunës.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Në Komunën e Obiliqit, Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.

Komuna e Obiliqit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është

Informacion i përgjithshëm

Territori i Komunës së Obiliqit është me një sipërfaqe një sipërfaqe prej 105 km², me 19 vendbanime. Komuna e Obiliqit, ka mbi 25.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje pre 21 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Qeveria komunale, numëron gjithsej 6 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 98.

miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin Social-Ekonomik Lokal.

Krahasimi me vitin paraprak

Nëse e krahasojmë me vitin 2010, del se Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të rregullta me vitin 2011, pra me nga 12 mbledhje. Ndërsa, sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, në vitin 2010 ka mbajtur 1 mbledhje, kurse në vitin 2011 ky Kuvend ka mbajtur 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Gjithashtu edhe Komitetet e obligative krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 del se kanë mbajtur numër më të vogël të mbledhjeve. KPF-ja në vitin 2010 ka mbajtur 13 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje. Kurse KK-ja ka mbajtur 3 mbledhje në vitin 2010, ndërsa 4 mbledhje në vitin 2011.

Kurse sa i përket miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka qenë mjaft aktive në miratimin e tyre. Në vitin 2011, ky Kuvend ka miratuar 62 vendime dhe 4 rregullore. Kurse numri i këtyre akteve të miratuara në vitin 2010 ka qenë 66 vendime dhe 4 rregullore. Nga kjo vërehet se në vitin 2010, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale.

31.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

- Shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit me të cilin aprovohet kërkesa e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për rritjen e numrit të anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa prej 9 në 11. MAPL ka konstatuar se një vendim i tillë është në kundërshtim me Statutin e Komunës së Obiliqit. Edhe pas kërkesës për rishqyrtim të këtij vendimi, komuna nuk ka marrë parasysh rekomandimet e dhëna.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Obiliqit

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 2133 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara janë 1948 ose 91.32% të shqyrtuara. Komuna e Obiliqit ka ofruar informata për këto drejtori:

Nga kjo vërehet se në vitin 2011 kemi zvogëlim të efikasitetit në organet administrative të komunës së Obiliqit në krahasim me vitin 2010 ku gjithsejtë janë shqyrtuara ose 92.54% Nga kjo konstatohet se deri sa në vitin 2010 janë shqyrtuar 92.54% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është zvogëluar në 91.32%.

Komuna e Obiliqit ka ofruar këto të dhëna:

1 Kryetari i Komunës: janë pranuar gjithësejt 120 kërkesa, të shqyrtuara janë 115, ndërsa të pashqyrtuara janë 5 kërkesa.

2 Drejtorja për Administratë: janë pranuar gjithësejt 512 kërkesa, prej tyre 503 janë të shqyrtuara, ndërsa 9 kërkesa janë të pa shqyrtuara.

3 Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: janë pranuar gjithësejt 208 kërkesa, të shqyrtuara janë 200, të pashqyrtuara janë 8 kërkesa.

4 Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë: janë pranuar gjithsejt 750 kërkesa të shqyrtuara janë 722 kërkesa të pashqyrtuara janë 28 kërkesa.

5 Drejtorja Kulturë, Rini dhe Sport: janë pranuar gjithësejt 17 kërkesa të shqyrtuara janë 15, të pashqyrtuara janë 2 kërkesa.

6 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar gjithësejt 70 kërkesa, të shqyrtuara janë 33, të pashqyrtuara janë 37 kërkesa.

86

7 Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike: ka pasur gjithsej 79 kërkesa, të shqyrtuara janë 75, të pashqyrtuara janë 4 kërkesa.

8 Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar gjithësejt 15 kërkesa, të shqyrtuara janë 10 të pashqyrtuara janë 5 kërkesa.

9 Drejtoria për Inspeksion: janë pranuar gjithësejt 63 kërkesa, të shqyrtuara janë 19, të pashqyrtuara janë 44 kërkesa.

10 Drejtoria për Arsim: janë pranuar gjithësejt 104 kërkesa, të shqyrtuara janë 76 kërkesa, të pashqyrtuara janë 28 kërkesa.

11 Zyra Lokale për Komunitete: janë pranuar gjithësejt 5 kërkesa, asnjëra nuk është shqyrtuar.

12 Zyra e Personelit: I ka pranuar gjithësejt 10 kërkesa, 8 janë të shqyrtuara ndërsa 2 të pashqyrtuara.

13 Sektori në Tatim në Pronë: janë pranuar gjithësejt 173 kërkesa të gjitha janë shqyrtuar.

10 Sektori i Prokurimit: janë pranuar gjithësejt 7 kërkesa, asnjëra nuk është shqyrtuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Obiliqit

Gjatë vitit 2011, Komuna e Obiliqit ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, dhe 2 mbledhje të jashtëzakondëshme.

Këto Komuna, kanë vepruar brenda dinamikës së paraparë të mbajtjes së mbledhjeve, ashtu siç parashihej me LVL.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktivitetet e Komunave bëhet përmes shpalljeve publike

dhe ueb faqes së Komunave. Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2011 e ka miratuar plotësim, ndryshimin e Statutit të Komunës. Gjithashtu Kuvendi i Komunës së Obiliqit në marrjen e Vendimit për rritjen e numrit të komitetit për politik dhe financa nga 9 (nëntë) në 11 (njëmbëdhjetë), ka pasur pakënaqësi nga opozita, dhe i njëjti vendim është në kundërshtim me nenin 413, të statutit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit. Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihej që Kryetari i Komunës të raportonte para Kuvendit së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në Komunën e Obiliqit, Kryetari i Komunës ka raportuar 2 herë. Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendim marrjes, komuna ka organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, Komuna e Obiliqit, ka mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë.

31.1

REKOMANDIME

- Të harmonizohet Statuti i Komunës me numrin e anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.
- Të respektohet neni 68 i LVL-së në lidhje me mbajtjen e takimeve publike me qytetarë;
- Komuna e Obiliqit të marrë parasysh të gjitha kërkesat për rishqyrtim të akteve komunale të cilat janë rrjedhojë e vlerësimeve të MAPL-së si dhe komisioneve ndërministrrore;
- Komuna e Obiliqit të respektojë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komuna e Obiliqit të funksionalizojnë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunën e Obiliqit, KKSB të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAP.

KOMUNA E VITISË

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, në bazë të monitorimit të rregullt të kuvendit rezulton se Kuvendi i Komunës së Vitisë ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve me gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga Kuvendi i Komunës së Vitisë janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt të mos merr pjesë në punën e Kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe nga pozita.

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Vitisë i ka funksionale Komitetet e Obligueshme. Në këtë drejtim KPF ka mbajtur 12 mbledhje, ndërsa KK 8 mbledhje.

Gjithashtu janë funksionale edhe komitete konsultative.

Në tërësi, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar gjithsejtë 23 akte komunale. Prej tyre janë miratuar 21 vendime dhe 2 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, nga qytetarët e Komunës.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të

Informacion i përgjithshëm

KKomuna e Vitisë përbëhet prej 43 vendbanimesh me qendër në Viti, me një sipërfaqe prej 300 km², dhe me një popullsi prej rreth 60.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është 10, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 178.

Komunës, sipas të dhënave në dispozicion. Në Komunën e Vitisë, Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi kanë mbajtur 9 mbledhje. Komuna e Vitisë ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin Social-Ekonomik Lokal.

Krahasimi me vitin paraprak

Nëse e krahasojmë me vitin 2010, del se Kuvendi i Komunës së Vitisë ka mbajtur numër më të madh të mbledhjeve të rregullta në vitin 2011 me gjithsejtë 12 mbledhje, kurse në vitin 2010 janë mbajtur 10 mbledhje. Sa i përket

mbledhjeve të jashtëzakonshme, në periudhën janar – dhjetor të vitit 2010 dhe atë të vitit 2011 nuk ka pasur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Sa i përket Komiteteve të obligueshme, krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011 del se kanë mbajtur numër më të madh të mbledhjeve. Në këtë drejtim, KPF-ja në vitin 2010 ka mbajtur 7 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 12 mbledhje. KK-ja në vitin 2010 ka mbajtur 3 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 8 mbledhje.

Kurse sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka qenë mjaft aktivë në miratimin e tyre. Në vitin 2011 janë miratuar 21 vendime dhe 2 rregullore, ndërsa në vitin 2010 janë miratuar 17 vendime dhe 4 rregullore. Nga kjo vërehet se Kuvendi i Komunës së Vitisë në vitin 2011 ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale.

32.1

EVIDENTIM I SHKELJEVE LIGJORE

- Kuvendi i Komunës së Vitisë nuk ka respektuar plotësisht dispozitat e LVL-së me rastin e plotësim-ndryshimin e Statutit të Komunës. MAPL pas shqyrtimit të ligjshmërisë ka bërë kërkesë që i njëjti të kthehet për rishqyrtim dhe harmonizim me legjislacionin në fuqi.
- Kuvendi i Komunës së Vitisë ka marrë vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pa respektim të procedurave që kërkohen me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale. Kërkesa e MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimi nuk është marrë parasysh nga ana e Komunës së Vitisë.
- Shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së Rregullores për organizimin dhe funksionimin e administratës komunale. Në bazë të kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të kësaj rregulloreje, Komuna është në proces të ndryshimit të saj.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Vitisë

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 2044 kërkesa, të shqyrtuara 1563 kërkesa ose 76,46%. Komuna e Vitisë ka ofruar informata për këto drejtori: Nga kjo vërehet se në vitin 2011 kemi zvogëlim të efikasitetit në organet administrative të komunës së Vitisë në krahasim me vitin 2010 ku gjithsejtë janë shqyrtuara 94.99% të kërkesave të qytetarëve. Nga kjo konstatohet se deri sa në vitin 2010 janë shqyrtuar 94.99% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është zvogëluar në 76.46%.

Komuna e Vitisë ka ofruar këto të dhëna:

1 Zyra e Kryetarit : janë pranuar gjithësejtë 35 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuara.

2 Drejtorja për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsejtë 1319, të shqyrtuara janë 1228, të pashqyrtuara janë 90 kërkesa.

3 Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet - janë pranuar gjithsejtë 291, të

shqyrtuara janë 258, të pashqyrtuara janë 33 kërkesa.

4 Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodozi, Pronë dhe Kadastër - janë pranuar gjithsej 10 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuar.

5 Drejtoria për Arsim dhe Shkencë - janë pranuar 4 kërkesa, të pashqyrtuara janë të gjitha.

6 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 7 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuara.

7 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri - janë pranuar 87 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuara.

8 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - janë pranuar 26 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

9 Drejtoria për Punë të Inspektion - janë pranuar 340 kërkesa, të shqyrtuara janë 337 prej tyre.

10 Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim - janë pranuar gjithësejt 63 kërkesa, prej tyre 50, të pashqyrtuar janë 13 kërkesa.

11 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar gjithësejt 31 kërkesa të gjitha janë të pashqyrtuara.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Vitisë

Gjatë vitit 2011, Komuna e Obiliqit ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta.

Këto Komuna, kanë vepruar brenda dinamikës së paraparë të mbajtjes së mbledhjeve, ashtu siç parashihet me LVL.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktiviteteve të Komunave bëhet përmes

shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunave. Në komunën e Vitisë është miratuar Statuti i ri i Komunës ku edhe është harmonizuar me drejtorit të cilat i ka pasur jashtë Statutit. Këtij Statuti ju është bërë vlerësimi nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për tu kthyer në rishqyrtim në Kuvendin Komunës së Vitisë, por që asnjëherë nuk është rishqyrtuar nga Kuvendi i Komunës, dhe nuk është diskutuar për pikat të cilat nuk kanë qenë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihet që Kryetari i Komunës të raporton para Kuvendit së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në Komunën e Vitisë, Kryetari Komunës ka raportuar 2 herë. Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendim marrjes, komuna ka organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, Komuna e Vitisë, ka mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë.

32.2

REKOMANDIME

- Të harmonizohet Statuti i Komunës me të gjitha pikat kontestuese të cilat i ka pasur vërejtje Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Të respektohet neni 68 i LVL-së në lidhje me mbajtjen e takimeve publike me qytetarë;
- Komuna e Vitisë të marrë parasysh të gjitha kërkesat për rishqyrtim të akteve komunale të cilat janë rrjedhojë e vlerësimeve të MAPL-së si dhe komisioneve ndërministrorë;
- Komuna e Vitisë të respektojë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komuna e Vitisë të funksionalizojë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunën e Vitisë, KKSb të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL.

KOMUNA E KLLOKOTIT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Kllokotit përbëhet prej 4 fshatrave me qendër në Kllokot, me një sipërfaqe prej 23.39 km² katrorë. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 2706 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është 5, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 55.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, në bazë të monitorimit të rregullt të Kuvendit rezultoi se Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve me gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga ky Kuvend janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt të mos merr pjesë në punën e Kuvendit .

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Kllokotit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme.

Në Komunën e Kllokotit, KPF ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa KK 11 mbledhje.

Në tërësi, Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka miratuar gjithsejtë 18 akte komunale. Prej tyre janë nxjerrë 14 vendime dhe 4 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 1 kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare nga qytetarët e Komunës.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi në këtë komunë ka mbajtur 10 mbledhje.

Komuna e Kllokotit ka miratuar Buxhetin Komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që

është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale.

Krahasimi me vitin paraprak

Nëse e krahasojmë me vitin 2010 del se Kuvendi i Komunës së Klllokotit ka mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të rregullta me vitin 2011, pra me gjithsejtë 12 mbledhje. Sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, në periudhën janar – dhjetor të vitit 2010 nuk ka pasur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa në vitin 2011 janë mbajtur 3 mbledhje të jashtëzakonshme.

Gjithashtu edhe tek Komitetet e obligative krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011 del se kanë mbajtur numër më të madh të mbledhjeve. KPF-ja në vitin 2010 ka mbajtur 6 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 11 mbledhje. KK-ja në vitin 2010 ka mbajtur 5 mbledhje, ndërsa në vitin 2011, ka mbajtur 11 mbledhje.

Kurse sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Klllokotit ka qenë mjaft aktive në miratimin e tyre. Në vitin 2011 janë miratuar 29 vendime dhe 6 rregullore, kurse numri i këtyre akteve të miratuara në vitin 2010 ka qenë 25 vendime dhe 5 rregullore. Nga kjo vërehet se në vitin 2011 Kuvendi i Komunës së Klllokotit ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Klllokotit

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 345 kërkesa, të shqyrtuara 263 kërkesa ose 76,23%. Komuna e Klllokotit ka ofruar informata për këto drejtori:

Nga kjo vërehet se në vitin 2011 kemi rritje të efikasitetit në organet administrative të komunës së Klllokotit në krahasim me vitin

2010 ku gjithsejtë janë shqyrtuara ose 55.47% të kërkesave të qytetarëve.

Nga kjo konstatojmë se deri sa në vitin 2011 janë shqyrtuar 76.47% të kërkesave, në vitin 2011 kjo përqindje është rritur në 76.47%.

Komuna e Klllokotit ka ofruar këto të dhëna:

1 Drejtorja për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 151, kërkesa të shqyrtuara janë të gjitha.

2 Drejtorja për Buxhet dhe Financa - janë pranuar gjithsej 15 kërkesa të shqyrtuara janë të gjitha.

3 Drejtorja për Urbanizëm, Gjeodezi, dhe Kadastër - janë pranuar gjithsej 118 kërkesa, të shqyrtuara janë 36 kërkesa ndërsa të pashqyrtuara janë 82 kërkesa.

4 Drejtorja për Arsim dhe Shkencë - janë pranuar 11 kërkesa, të gjitha janë të gjitha.

5 Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - janë pranuar 30 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

6 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 20 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Klllokotit

Gjatë vitit 2011, Komuna e Klllokotit ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakondëshme.

Këto Komuna, kanë vepruar brenda dinamikës së paraparë të mbajtjes së mbledhjeve, ashtu siç parashihet me LVL.

92

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktiviteteve të Komunave bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunave.

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihet që Kryetari i Komunës të raporton para Kuvendit së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në Komunën e Kllokotit, Kryetari i Komunës ka raportuar 2 herë.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendim marrjes, komuna ka organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, Komuna e Kllokotit ka mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë.

33.1

REKOMANDIME

- Komuna e Kllokotit të respektojë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komuna e Kllokotit të funksionalizojë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunë e Kllokotit, KKSBB të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL;
- Komuna e Kllokotit të sigurojë përkthimin e të gjitha akteve të miratuara në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës.

34

KOMUNA E PARTESHIT

Informacion i përgjithshëm

Komuna e Parteshit përbëhet prej 3 fshatrave me qendër në Pasjan, me një sipërfaqe prej 28.66 km² katrorë.

Popullsia në këtë komunë sillet rreth 2217 banorë.

Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është 6, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 26.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2011, në bazë të monitorimit të rregullt të Kuvendit rezultoi se Kuvendi i Komunës së Parteshit ka mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve me gjithsejtë 9 mbledhje të rregullta dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme.

Ftesat dhe materialet për mbledhje të Kuvendit janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur raste që nuk janë mbajtur mbledhjet e Kuvendit për arsye të mos miratimit të rendit të ditës, si dhe mos pajtimeve të subjekteve të politike të përfaqësuara në Kuvend. Prej tyre kanë dështuar dy mbledhje.

Rrjedha e punës së Kuvendit është shoqëruar me diskutime të ndryshme qoftë nga pozita qoftë nga

opozita. Pozita ka qenë shumë konstruktive në punën e Kuvendit, ndërsa opozita ka qenë shumë kritikuese dhe kryesisht në gjysmën e dytë të vitit 2011 është marrë me bllokimin e punës së Kuvendit duke aluduar se Kryesuesi i Kuvendit nuk ka qenë në nivelin e duhur të udhëheqjes. Me këtë rast ka kërkuar edhe shkarkimin e tij pothuajse gjatë gjithë kohës.

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Parteshit i ka funksionale Komitetet e Obligueshme.

Në Komunën e Parteshit, KPF ka mbajtur 9 mbledhje, ndërsa KK 3 mbledhje.

Gjithashtu janë funksionale edhe komitete konsultative.

Në tërësi, Kuvendi i Komunës së Parteshit ka miratuar gjithsejtë 22 akte komunale. Prej tyre janë miratuar 16 vendime dhe 6 rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, nga qytetarët e Komunës.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës.

Në Komunën e Parteshit, Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi kanë mbajtur 2 mbledhje. Ky Këshill nuk i është përmbajtur U.A. nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL për KKSB, me të cilin parashihet që brenda një viti të mbahen së paku 10 takime.

Komuna e Hanit të Elezit e ka të miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe Lista e Projekteve Prioritare për investimet kapitale

Krahasimi me vitin paraprak

Nëse e krahasojmë me vitin 2010 del se Kuvendi i Komunës së Parteshit ka mbajtur

numër më të madh të mbledhjeve të rregullta në vitin 2011 me 9 mbledhje të mbajtura. Kurse, në vitin 2010 i ka mbajtur vetëm 6 mbledhje për arsye se është themeluar më vonë si Komunë. Sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, në vitin 2010 nuk ka pasur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa në vitin 2011 janë mbajtur 3 mbledhje.

Gjithashtu edhe tek Komitetet e obligueshme të Komunës së Parteshit, krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 del se kanë mbajtur numër më të madh të mbledhjeve. KPF-ja në vitin 2010 ka mbajtur 2 mbledhje, ndërsa në vitin 2011 ka mbajtur 9 mbledhje. KK-ja në vitin 2010 ka mbajtur 1 mbledhje, ndërsa në vitin 2011, ka mbajtur 3 mbledhje.

Kurse sa i përket akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Parteshit ka qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale në vitin 2011, ku gjatë kësaj periudhe janë miratuar 16 vendime dhe 6 rregullore. Ndërsa, numri i këtyre akteve të miratuara në vitin 2010 ka qenë 18 vendime dhe 3 rregullore. Nga kjo vërehet se në vitin 2011 Kuvendi i Komunës së Parteshit ka qenë më aktiv në miratimin e akteve komunale.

Efikasiteti i organeve të administratës në Komunën e Parteshit

Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 2292 kërkesa, të shqyrtuara 2292 kërkesa ose 100%.

Komuna e Parteshit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

1 Drejtorja për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 1543, kërkesa të shqyrtuara janë të gjitha.

2 Drejtorja për Buxhet dhe Financa - janë pranuar gjithsej 616 kërkesa të shqyrtuara janë të gjitha.

3 Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, dhe Kadastër – nuk ka të dhëna për kërkesat.

4 Drejtoria për shërbime publike, siguri, dhe situata emergjente - janë pranuar 37 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

5 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - nuk ka të dhëna për kërkesat.

6 Drejtoria për Arsim, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 96 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

Vështrim i përgjithshëm mbi funksionimin e organeve të Komunës së Parteshit

Gjatë vitit 2011, Komuna e Kllokotit ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakondëshme.

Këto Komuna, kanë vepruar brenda dinamikës së paraparë të mbajtjes së mbledhjeve, ashtu siç parashihet me LVL.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktiviteteve të Komunave bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së Komunave.

Rrjedha e punës së Kuvendit është shoqëruar me diskutime të ndryshme qoftë nga pozita qoftë nga opozita.

Pozita ka qenë shumë konstruktive në punën e Kuvendit, ndërsa opozita ka qenë shumë kritikuese dhe kryesisht në gjysmën e dytë të vitit 2011 është marrë me bllokimin e punës së Kuvendit duke aluduar se Kryesuesi i Kuvendit nuk ka qenë në nivelin e duhur të udhëheqjes.

Me këtë rast ka kërkuar edhe shkarkimin e tij pothuajse gjatë gjithë kohës.

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihet

që Kryetari i Komunës të raporton para Kuvendit së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në Komunën e Parteshit, Kryetari Komunës ka raportuar 2 herë.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë që qytetarët të jenë pjesë e propozimeve, kërkesave dhe të jenë sa më aktiv në procesin e vendim marrjes, komuna ka organizuar takime publike me qytetarë. Në këtë drejtim, Komuna e Parteshit ka mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë.

33.1

REKOMANDIME

- Komuna e Parteshit të respektojë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komuna e Parteshit të funksionalizojë softuerin CMS/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- Në Komunë e Parteshit, KKSB të jetë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL;
- Komuna e Parteshit të sigurojë përkthimin e të gjitha akteve të miratuara në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës;
- Komuna e Kllokotit të sigurojë përkthimin e të gjitha akteve të miratuara në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës.

SHKELJET LIGJORE TË KOMUNAVE

Divizioni i Monitorimit gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011 ka evidentuar shkeljet ligjore në Komuna. Më pas, shkeljet e evidentuara janë adresuar për shqyrtim të ligjshmërisë në Departamentin Ligjor të MAPL-së. Natyra e shkeljeve të evidentuara gjatë procesit të monitorimit, kryesisht lidhet me:

- Emërimet në postin e Zëvendëskryetarit të Komunës për Komunitete dhe Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, në kundërshtim e dispozitat e nenit 54 dhe nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Themelimin e ndërmarrjeve publike në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Bartjen e pronës shoqërore në emër të pronësisë komunale;
- Dhënien e pronës komunale në shfrytëzim pa i respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226.
- Shtimi i drejtorive në komuna pa ndryshim paraprak të Statutit të Komunës.
- Mosharmonizimi i Statutit të Komunave me numrin e drejtorive komunale.
- Mosdërgimi i akteve komunale me kohë për vlerësimin e ligjshmërisë;

KONKLUZIONE

Në bazë të të dhënave që i posedon MAPL-ja për periudhën janar – dhjetor të vitit 2011, japim konkluzionet si vijon:

- Përgjithësisht, komunat kanë funksionuar normalisht dhe nuk janë shënuar raste të shumëta të bojkotimit të mbledhjeve.
- Të gjitha komunat kanë miratuar propozim-buxhetin për vitin 2012.
- Gjatë kësaj periudhe nuk janë vërejtur raste të mbajtjes së pozitave të dyfishta.
- Një pjesë e komunave gjatë kësaj periudhe kanë bërë ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës (Prishtina, Podujeva, Gjilani dhe Ranillugu);
- Ende në disa komuna nuk është harmonizuar Statuti i Komunës me numrin e drejtorive.
- Komuna e Kaçanikut dhe Shtërpçës nuk i kanë funksionale Komitetet për Komunitete;
- Komuna e Graçanicës nuk e ka të emëruar nënkryetarin e Komunës për Komunitete;
- Në shumicën e komunave nuk kanë qenë funksionale Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi;
- Jo të gjitha komunat kanë respektuar afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve.
- Një pjesë e madhe e komunave nuk kanë marrë parasysh kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të ligjshmërisë së akteve komunale.
- Përgjithësisht kryetarët e komunave kanë raportuar në Kuvendet e Komunave.

REKOMNADIMET E PËRGJITHSHME

Në bazë të të gjeturave në raport, Divizioni i Monitorimit ka vënë në theks disa rekomandime për komunat, të paraqitura si në vijim:

- Kriteri ligjor i kërkuar për mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë një viti, i përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, të jetë i zbatueshëm nga të gjitha komunat.
- Të harmonizohen Statutet e Komunave në raport me numrin e drejtorive dhe anasjelltas.
- Kryetarët e komunave të përmbushin obligimin për raportim para Kuvendit të Komunës, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
- Të respektohet neni 68 i LVL-së në lidhje me mbajtjen e takimeve publike me qytetarë;
- Komuna e Graçanicës të emëroj nënkryetarin e Komunës për Komunitete;
- Komuna e Graçanicës, Parteshit dhe Kllokotit të sigurojnë përkthimin e të gjitha akteve të miratuara në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës;
- Komunat të marrin parasysh të gjitha kërkesat për rishqyrtim të akteve komunale të cilat janë rrjedhojë e vlerësimeve të MAPL-së si dhe komisioneve ndërmimore.
- Të funksionalizohen Komitetet e obligueshme ashtu siç përcaktohet me nenin 53.1 dhe 53.2 të LVL-së;
- Komunat të respektojnë afatet kohore me rastin e dërgimit të ftesës dhe materialeve të mbledhjeve ashtu siç përcaktohet me LVL-në;
- Komunat të funksionalizojnë softuerin CMS-/CSC në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2011;
- KKSb-të të jenë më aktive në mbajtjen e mbledhjeve, në mënyrë që të respektohet plotësisht Udhëzimi Administrativ nr. 08/2-009 MPB – 02/2009 MAPL.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i kompletuar është hartuar nën mbikëqyrjen e znj. Rozafa Ukimeraj- Drejtoreshë e Departamentit për Vetëqeverisje Lokale dhe z. Xhevat Tafa – Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave;

Raporti është hartuar nga zyrtarët përgjegjës të Komunave:

Diellor Gashi - Gjakovë, Deçan, Rahovec, Junik
Gëzim Sahiti - Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë, Graçanicë
Hamit Fazliu - Mitrovicë, Glogoc, Skënderaj, Vushtrri
Kujtim Aliu - Viti, Obiliq, Han i Elezit, Kllokot dhe Partesh
Manushaqe Muçaj - Pejë, Klinë, Istog, Malishevë
Mimoza Bajraktari - Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash
Zajrete Sylejmani - Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Podujevë
Yll Valla - Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Ranillug

Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në pjesë të raportit janë përgjegjës zyrtarët e Divizionit të Monitorimit.

E Drejta autoriale e këtij raporti i takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.